

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7607 E mërkurë 1 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Gati 65 për qind e 3.3 miliardë eurove që harxhon çdo vit Buxheti i Shtetit (duke hequr fondin e pagave, të pensioneve dhe të sigurimeve shoqërore ...

Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Gati një në çdo tre tendera e zhvillojmë duke biseduar!



Opinion

Ditës

Mbase kishte minuta, por në fakt kishin qenë orë dhe ne bisedonim... Jashtë binte shi i imët, e kuptonim sepse të gjithë ata që hynin në hotel ...

Vijon në faqen 21

Nga PËRPARIM KABO

Requiem për Luan Hajdaragën!  
Do doja të ishte ndryshe mik...



"Miratimi i nenit 6, në kundërshtim me objektivat sociale"

## Presidenti kthen pas ligjin "Për tatimet": Ndryshimet favorizojnë vetëm lojërat e fatit

Arsyetimi i kreut të shtetit: Efektet në ekonominë familjare janë negative

DARINA TANUSHI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i ktheu Kuvendit për rishqyrtim një tjetër ligj, pas ligjit për Teatrin Kombëtar. Presidenti vlerëson se ligji nr. 39/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 ...

Në faqen 3

VENDIMI I QEVERISE, SA DO TË JETE SHITESA MAKSIMALE DHE MINIMALE NE MUAJ

## RRITJA E PENSIONEVE PER 730 MIJE VETA, PERFITUESIT

Shembujt konkretë në përlogaritje dhe kategoritë që do të kenë të drejtën e kompensimit. Sa do të marrin ushtarakët, minatorët e të moshuarit



(Në foto) Pensionistë

Në faqen 7

KRYEMINISTRI

Rama: Në shtator kemi ofertë të re për opozitën. Presim lajm të mirë nga SHBA

Në faqen 5

HISTORIA DHE ARRESTIMI

Planifikoi një sulm terrorist në Australi, dënohet me 17 vite burg i riu shqiptar

Në faqen 8

HAPAT E PROCEDURA

Lista me 1293 personat që kanë gati lejet e legalizimeve, ALUIZNI: Ja emrat e përfituesve

Në faqen 9-12

REAGIMET

Komisioni European: Jemi duke shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjit të Teatrit me MSA-në

Në faqen 19

Raporti i DASH për klimën e investimeve në Shqipëri përplas qeverinë e opozitën

## Basha: Ekonomia po vdes, e tha DASH. Rama: Gabim në përkthim

Ahmetaj: Partneriteti Publik Privat nuk u shpik në Shqipëri, përdoret edhe në botë

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve në Shqipëri është lexuar në mënyra të ndryshme nga palët politike në vend. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama se së bashku me një grup



oligarkësh po plaçkitin e shkatërrojnë ekonominë. Ndërsa pas tij, në një reagim në rrjetin social "Facebook", kryeministri Rama e cilëson PD si seli të përkthimeve të gabuara. "Sëlla e Përkthimeve të Gabuara e di raportin ...

Në faqen 2

SKUADRA TË GRUPIN C, ME KE DO LUAJE EKIPI YNE



Minitubballi, Shqipëria gati për Kampionatin Europian. "Hysenbelliu Group", sponsor gjeneral

Në faqen 18

## RAPORTI I DASH REAGIMET

Raporti i DASH, kryeministri e kreu i PD-së vijnë përplasjet

# Basha: Ekonomia po vdes, e tha DASH. Rama: E ke përkthyer gabim

*Kreu i qeverisë: Raporti nuk është ferman kundër qeverisë*

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për klimën e investimeve në Shqipëri është lexuar në mënyra të ndryshme nga palët politike në vend. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama se së bashku me një grup oligarkësh po plaçkitin e shkatërrojnë ekonominë. Ndërsa pas tij, në një reagim në rrjetin social "Facebook", kryeministri Rama e cilëson PD si seli të përkthimeve të gabuara. "Sella e Përkthimeve të Gabuara e di raportin vjetor të Departamentit të Shtetit për 170 vende, ferman kundër qeverisë. Do luftë kundër korrupsionit e lufton vetingun. Do pushtetin e thotë kur ishim më keq ishim më mirë. Po do, s'do ajo seli, plaçgë po luftohen sot si kur më parë", shkroi dje Rama. Nga ana e tij, kreu i PD-së u shpreh: "Ekonomia shqiptare po vdes përditë si pasojë e plaçkitjes dhe shkatërrimit nga Edi Rama dhe një grusht oligarkësh me të cilët ai ndan qindra miliona. Tashmë është e qartë se i vetmi qëllim dhe i vetmi motivim i Edi Ramës për pushtet është pasurimi përrallor. Prandaj - shtoi më tej Basha - e vetmja politikë ekonomike që Rama ka ndjekur këto pesë vjet ka qenë plaçkitja: 1. Vjedhja e taksave të qytetarëve duke ua dhënë klientëve në koncesione dhe kontrata abuzive. 2. Vjedhja e pasurive të vendit nga nafta dhe mineralet tek tokat në bregdet e deri tek tokat në mes të Tiranës dhe 3. Grabitja e investitorëve të huaj për t'i përzënë apo mbajtur larg nga Shqipëria që të mos u bëjnë konkurrencë oligarkëve". Sipas tij, "qeveria amerikane është institucioni më i fundit që po konfirmon politikën korruptive dhe kriminale të Edi Ramës. Raporti i fundit i Departamentit të Shtetit për klimën e biznesit në botë thekson se Shqipëria nuk është vend i përshtatshëm për bizneset amerikane për shkak të korrupsionit, mungesës së shtetit ligjor, korrupsionit në PPP dhe prokurimeve publike dhe mungesës së konkurrencës". Për kreun e PD-së, "raporti ka nota negative për çdo aspekt të klimës së biznesit dhe qeverisjes, por fakti më i rëndë që dëshmon nivelin kriminal të qeverisë 'Rama' në ekonomi është pohimi se investitorëve të huaj, Edi Rama u bën shantazh të bashkëpunojnë me klientët e tij ose përndryshe nuk kanë shans të investojnë. Duket se plaçkitja e Shqipërisë dhe shqiptarëve nuk i ka mjaftuar Edi Ramës, ndaj kërkon të grabisë edhe amerikanët, europianët dhe këdo që kërkon të bëjë biznes në Shqipëri. Prandaj - vijoi ai më tej - Sh-



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

### PETRIT VASILI

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së tha dje se kryeministri i lodhur vetëpërkëdhelet. "Media e kapur dhe kërcënuar nga qeveria, pastrim masiv i parave të pista të trafiqeve dhe krimin të organizuar, korrupsion i shfrenuar, biznese kliente të qeverisë, vjedhje gjigante me koncesione, këto po shkatërrojnë vendin dhe këtë e thotë Departamenti Amerikan i Shtetit", tha Vasili.

## Ministri i Financave u përgjigjet kritikave të DASH

Ahmetaj: Partneriteti Publik Privat nuk u shpik në Shqipëri, përdoret edhe në botë

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj deklaroi dje se Partneriteti Publik Privat përdoret në të gjithë botën dhe nuk u shpik në Shqipëri. Në një bashkëbisedim me gazetarët, ministri i Financave iu përgjigj edhe kritikave të raportit të DASH për klimën e investimeve në Shqipëri. Sipas Ahmetajt, implementimi i plotë i Reformës në Drejtësi do të largonte korrupsionin, rriste investimet e huaja dhe bënte Shqipërinë konkurruese në ekonominë botërore. "Raporti thekson domosdoshmërinë e klimës së biznesit dhe tërheqjes së investimeve të huaja. Në raport ka referenca për korrupsionin në drejtësi. Një



nga paragrafët e raportit i referohet korrupsionit në drejtësi, si një nga problemet kryesore të prishjes së të bërit biznes. Nëse do të implementohet tërësisht, reforma në drejtësi do të promovojë investimet e huaja, do largojë korrupsionin dhe do lërë Shqipërinë të konkurrojë në ekonominë botërore", u shpreh ministri i Financave. Sipas tij, "kjo është një thirrje për të gjithë ata që tentojnë të pengojnë vetëingun apo reformën në drejtësi.

qipëria është vendi i vetëm në botë që nuk ka pasur asnjë investim të ri të huaj gjatë pesë viteve të fundit. Prandaj nuk janë krijuar vende të reja pune. Prandaj nuk ka mundësi për sipërmarrje ekonomike. Kështu vendi është zhytur në varfëri dhe pesimizëm dhe shqiptarët i

janë drejtuar masivisht emigracionit, nga të papunët, tek profesionistët, tek sipërmarrësit e ndershëm. Në pesë vjet Edi Rama e ktheu Shqipërinë në një vend që ofron mundësi vetëm për hajdutët dhe kriminelët. Kombinimi i krimi i fortë + ekonomi e dobët është minë me sahat për çdo sho-

si. Ata vendosen kundër interesave qytetare. Është kjo qeveri që ka iniciuar dhe po mbështet me të gjithë instrumentet implementimin e reformës në drejtësi. Ka plot probleme e çështje për t'u përmirësuar në ambientin ekonomik shqiptar. Dua të tërheq vëmendjen te mjedisi politik e siguria. Sot vjedhja politike është e rrallë. Zgjedhjet në vitin 2017 ishin të qeta, si rrallë më parë. DASH sjell në vëmendje vrasjen e protestuesve në vitin 2011. Për më tepër, DASH të theksin tek prokurimet publike dhe PPP. Partneriteti Publik Privat stigmatizohet, përdoret në të gjithë botën, nuk u shpik në Shqipëri", deklaroi Ahmetaj.

qeri. Kjo minë duhet çaktivizuar sa më parë, ndryshe do të shkretojë gjithçka. Është koha që të gjithë të bashkohen për të ndaluar rënien e vendit në humnerë, duke ndaluar Edi Ramën dhe çmontuar bandën e tij të oligarkëve dhe kriminelëve", e mbylli komentin e tij Basha.



Gjatë një seance parlamentare

### KLAJDA GJOSHA

Ish-ministria e Integritimit u shpreh dje se, "historia e koncesioneve është ajo më e rrezikshme që mund të kemi imagjinuar ndonjëherë. Shqipëria po afrohet një skenari grek të falimentit të shtetit, që mund të jetë katastrofike për shtetin dhe për çdo qytetar shqiptar".

### EDI PALOKA

Nënkryetari i PD-së, mes ironisë tha dje se Rama e kuptonte shumë mirë anglishten e ambasadorëve, por "nuk kupton" anglishten e përdorur në deklarata apo raporte nga shefat e ambasadorëve. Në këtë linjë Paloka shtoi se Rama nuk i kupton këto raporte, ndërsa shtoi se ai do të vazhdojë deri sa shqiptarët t'i thonë "Qërohu".

## Tabaku: Një në tre tendera në Shqipëri jepen pa garë

Deputetja e PD, Jorida Tabaku tha se sipas të dhënave të Gjykatës Europiane të Auditimit, 30% e tenderave në qeverinë "Rama" jepen përmes metodës korruptive të "Negocimit pa Shpallje". PD akuzoi dje qeverinë se një në tre tendera në Shqipëri jepen pa garë. Nënkryetaria e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku u shpreh se qeveria e Edi Ramës është kampione në Europë, përse i përket vjedhjes së taksave të qytetarëve të saj. Sipas saj, ajo vjedh 1/3 e taksave të shqiptarëve përmes tenderave publikë. "Kjo është dhe arsyeja pse Rama rriti taksat - tha Tabaku. - Njësoj, siç deklarua në pak javë më parë, të dhënat e Gjykatës Europiane të Auditimit tregojnë se 30% e tenderave në qeverinë 'Rama' jepen përmes metodës korruptive të 'Negocimit pa Shpallje'. Gjykatat Europiane e Auditit ka nxjerrë shifrat që faktikisht se 1 në 3 kompani përfiton abuzivisht nga tenderat, duke shmangur procedurat për një garë të ndershme, që do t'i kursenin buxhetit miliona euro nga taksat e shqiptarëve. Kjo do të thotë se 1 në 3 tendera jepet pa garë. Tani është botërisht i njohur fakti se qeveria është e angazhuar personalisht që në këto tendera të fitojnë kompanitë klientë të saj, të cilat ndajnë vjedhjen me vetë kryeministrin dhe ministrat e tij", tha Tabaku. Sipas saj, PD do të nisë një luftë pa kompromis ndaj korrupsionit jo vetëm si pengesë në procesin e integritetit, por edhe si arsyeja e vetme pse sot të rinjtë janë pa punë, pse rrogat dhe pensionet nuk rriten, pse nuk ka investime në rrugë, shkolla e spitale.





Argumentet ligjore të Metës: Keqorienton individët, përkeqëson ekonominë

# Presidenti i kthen Ramës dy ligje, pas teatrit, edhe "lojërat e fatit"

*"Qeveria e Kuvendi nuk e kanë vlerësuar në mënyrë të thelluar"*

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i ktheu Kuvendit për rishqyrtim një tjetër ligj, pas ligjit për Teatrin Kombëtar. Presidenti vlerëson se ligji nr. 39/2018 "Për disa ndryshime dhe shpëtim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar" duhet të vlerësohet edhe një herë nga Kuvendi, në mënyrë që kjo paketë fiskale të realizohet në atë mënyrë që të jetë tërësisht në interes të publikut dhe ekonomisë, duke mbështetur rritjen e mirëqenies familjare dhe aspak cenimin e saj. "Duke krahasuar efektet pozitive që vijnë nga zbatimi i barrës së lehtësuar fiskale ndaj operatorëve dhe bizneseve në fushën e lojërave të fatit, përkundrejt dramave sociale dhe konflikteve në familje që janë shkaktuar në vijimësi nga pjesëmarrja në lojërat e fatit, arrihet në konkluzionin se iniciativa propozuese për të lehtësuar barrën fiskale përkundrejt bizneseve të lojërave të fatit nuk është vlerësuar në mënyrë të thelluar nga qeveria dhe Kuvendi. Në aktet që shoqërojnë këtë propozim ligjor nuk ekzistojnë asnjë argument në këtë drejtim", argumenton presidenti.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

duhet të ishin vlerësuar me shumë kujdes dhe seriozitet nga qeveria dhe Kuvendi". "Bazuar në sa më sipër, në bindje të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në

pikën 1 të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës vlerëson se nenit 6 i ligjit nr.39/2018 nuk është në përputhje me objektivat sociale të shtetit Shqiptar të përcaktuar në nenin 59 të Kushtetutës, i paargumentuar nga ana ekonomike dhe për këto arsye ky ligj i duhet kthyer Kuvendit, me qëllim rishikimin e këtij neni. Së pari, ndryshimet e reallizuara në nenin 6, të ligjit nr. 39/2018, janë të paargumentuara dhe nga vlerësimi i tyre rezultojnë se, zbatimi i këtij neni do të sjellë përfitim vetëm në favor të bizneseve që operojnë në fushën e lojërave të fatit, ndërkohe efektet e prishme në buxhet apo në ekonominë familjare janë negative", thotë në argumentimin e tij presidenti. Meta shprehet se në dokumentacionin që shoqëron ligjin nuk rezultojnë të jetë arsyetuar qëllimi ekonomik i kësaj iniciative dhe nuk është trajtuar aspak çështja nëse mbështetja ndaj këtyre bizneseve nëpërmjet uljes së barrës fiskale, paraqet ose jo rrisht të shtuar për zgerim të aktivitetit të kësaj industrie dhe përhapjen e tyre masivisht në territorin e vendit, krahasuar kjo me impaktin social negativ që mund të sjellë prezencën e shtuar e këtij fenomeni në shoqëri. Në mungesë të arsyetimit për qëllimin ekonomik dhe social të iniciativës për miratimin e nenit 6 të ligjit nr.39/2018 është qartësisht e evidentueshme që përfituesi real i këtij reduktimi fiskal është vetëm operatori/ët ekonomikë që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e lojërave të fatit, ndërkohe që as buxheti i shtetit dhe as ekonomia në tërësi nuk përfitojnë nga aplikimi i këtij neni.

## Qeveria miraton marrëveshjen për njohjen e patentave me Greqinë

Qeveria shqiptare ka miratuar marrëveshjen me Greqinë për njohjen e ndërsjellët të patentave me Greqinë. Marrëveshja midis dy vendeve u arrit më 11 maj të këtij viti nga dy ministrit e Jashtëm, përkatësisht Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias. Njohja e lejeve të drejtimit ka ndikim pozitiv, pasi do të krijojë lehtësi në qarkullimin e automjeteve midis dy vendeve, ku përfituesit më të mëdhenj janë shtetasit shqiptarë për shkak të numrit të madh të tyre në Greqi. Marrëveshja parashikon që qytetarët shqiptarë të cilët kanë leje drejtimi shqiptare nuk do të kenë nevojë të rifillojnë procedurat e kualifikimit dhe të provës, për marrjen e lejes së drejtimit greke, e cila ka edhe një impakt financiar nga 700 deri në 1000 euro, për çdo leje drejtimi të marrë në Greqi. Qytetarët do të dorëzojnë lejen e drejtimit të marrë në Shqipëri dhe do të marrin atë greke duke u krijuar mundësi të qarkullojnë ose të punësohen si drejtues mjeti në Greqi, me të drejta të barabarta me shtetasit grekë. Njohja e ndërsjellët e lejeve të drejtimit është një rezultat i prekshtëm i paketës së çështjeve dypalëshe të diskutuar në Kretë dhe Korçë nga dy ministrit e Jashtëm dhe një punë të gjatë negociuese mes ministrive të Transportit të dy vendeve tona.



## LIGJET E DEKRETUARA

Ndërkaq, presidenti ka firmosur në dekretet e disa ligjeve siç janë: ai "Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", Ligji nr. 41/2018 "Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", ligji nr. 42/2018 "Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)" e disa marrëveshje të tjera.

## Meta liron nga detyra 6 ambasadorë dhe emëron 7 tjerë, mes tyre Virgjil Kule

Presidenti Ilir Meta dekretoi dje lirimin nga detyra të gjashtë ambasadorëve dhe emërimin në detyrë të 7 diplomatëve të tjerë. Në mesin e ambasadorëve të emëruar në detyrë është edhe Virgjil Kule për postin e ambasadorit të jashtëzakonshëm në Mbretërinë e Suedisë, Republikën e Finlandës, Islandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë. Në faqen zyrtare të Presidentit thuhet se Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 26, të ligjit nr. 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të kryeministrit, dekretoi:

### AMBASADORËT E LIRUAR

- **ILIR MELO**, ambasador në Kroaci, rezident, si dhe ambasador në Bosnjë dhe Hercegovinë, jorezident.
- **KASTRIOT ROBO**, ambasador në Mbretërinë e Danimarkës, rezident.
- **QIRJAKO KURETA**, ambasador në Bullgari, rezident, si dhe ambasador në Republikën e Moldavisë, jorezident.
- **RIZA PODA**, ambasador në Republikën e Çekisë, rezident.
- **ILIR ABDU**, ambasador në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si dhe ambasador në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe në Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident.
- **RIDI KURTEZI**, ambasador në Mbretërinë e Spanjës, rezident, si dhe ambasador në Mbretërinë e Marokut, Republikën Islamike të Mauritaniës dhe Principatën e Andorës, jorezident.

### AMBASADORËT E EMËRUAR

- **DONIKA HOXHA**, ambasadorë në Republikën e Bullgarisë, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqipotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Moldavisë, jorezident.
- **ELIDA PETOSHATI**, ambasadorë në Mbretërinë e Danimarkës, rezident.
- **ILIRIAN KUKA**, ambasador në Republikën e Çekisë, rezident.
- **REZAR BREGU**, ambasador në Republikën Federative të Brazilit, rezident.
- **RIZA PODA**, ambasador në Republikën e Kroacisë, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqipotë i Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, jorezident.
- **IRVIGJIL KULE**, ambasador në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqipotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe në Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident.
- **RIDI KURTEZI** emërohet në detyrën e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqipotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi, rezident.

## INTEGRIMI INTERVISTA

Ministri i Jashtëm, intervistë për Këshillin Atlantik: Po përparojmë me drejtësinë

# Bushati: Në Europë ka stereotipa negativë, që na lidhin me islamin

Shkëmbim territorësh Kosovë-Serbi? Të mos hapet kutia e Pandorës

**M**inistri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati tha dje se angazhimi i SHBA-ve në Ballkan është jetik për të siguruar që të mos ketë asnjë pengesë në përpjekjet e Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave e Maqedonisë (FYROM) për të normalizuar marrëdhëniet mes tyre, të cilat në vijim do t'i hapin rrugën kësaj të fundit për t'iu bashkuar NATO-s. Në një intervistë me zëvendës-presidentin Ekzekutiv të Këshillit Atlantik, Damon Wilson, Bushati diskutoi për rrugëtimin e Shqipërisë për anëtarësimin në BE, gjendjen aktuale të marrëdhënies me fqinjët dhe rolin që Shtetet e Bashkuara mund të luajnë në rajon në tërësi.

**Ju jeni një shoqëri me shumë bashkësi fetare, por jeni gjithashtu një vend me shumicë myslimane. A po ndikon kjo në rrugën tuaj drejt Bashkimit Evropian?**

Në jemi një shoqëri laike. Jemi evropiane dhe në këtë drejtim ka një vendosmëri të fortë si në spektrin politik, edhe në atë shoqëror për t'u bashkuar me BE-në. Ky është objektivi i dytë më i lartë kombëtar pas bashkimit dhe mbështetjes së NATO-s. Procesi i reformave po shkon shumë mirë. Sigurisht, ka edhe disa stereotipa negativë në Evropë që përpiqen të na lidhin me islamin, por që janë të pazabaz, pasi mënyra se si zhvillohet jeta publike në Shqipëri është në një mënyrë evropiane.

Mendoj se është e rëndësishme të shohim se Shqipëria është e mirëpritur në Evropë. Ju jeni evropiane. Sigurisht që brenda BE-së ka pasur një debat në mënyrë të ndryshme rreth çështjes së anëtarësimit të një vendi me shumicë myslimane, si për shembull Turqia. Por, deri më tani nuk ka qenë problem për Shqipërinë. Mendoj se shembulli që krijoni ju do të jetë i rëndësishëm.

Kjo nuk duhet të jetë një sfidë për Shqipërinë, sepse përndryshe do të krijonte një precedent negativ, jo vetëm për zhvillimet në rajon, por edhe për projektin evropian në tërësi. Tani ka më shumë myslimanë në Gjermani ose në Francë sesa në Shqipëri.

**Ju sapo kemi mirëpritur Komisionerin për Zgjerim, Johannes Hahn në Shqipëri më 17 korrik. Cilët mendoni se janë hapat e ardhshëm dhe piketat e mëdha në rrugën tuaj drejt BE-së?**

Procesi i shqyrtimit të paketës ligjore dhe institucionale është nisur zyrtarisht disa ditë më parë. Në shtator, ekspertët nga Komisioni Evropian dhe qeveria shqiptare do të ulen dhe do të arrijnë të kuptojnë më mirë mbi përparimin e Shqipërisë

në përbushjen e kapitujve përkatës të acquis communautaire paketa e ligjeve të BE-së. Në të njëjtën kohë, ky proces do të na japë mundësinë për të pasur një vlerësim të matur në lidhje me nivelin e përputhshmërisë së legjislacionit dhe institucioneve tona me ato të BE-së. Kjo është ajo që do të ndodhë në një nivel teknik. BE ka vendosur një afat kohor në rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë, kështu që në qershorin e ardhshëm shpresojmë se do të fillojmë negociatat zyrtare të anëtarësimit. Në besojmë se ky proces i shqyrtimit do të na ndihmojë. Së pari, do të kursëjë kohë dhe së dyti, do të na ndihmojë të jemi më të përgatitur për procesin e negociatave të anëtarësimit. Nuk ka asgjë që mund të negociojmë drejtpërdrejt me BE-në, është më shumë një proces përshtatshmërie. Ne do ta përdorim këtë periudhë kohore në një mënyrë shumë efektive, me ndihmën e Komisionit Evropian.

**Duket sikur ka shumë këmbëngulje në nxjerrjen e disa prej çështjeve të vështira që vendit tuaj i është dashur të ballafaqohet, të tilla si sundimi i ligjit dhe çështjet e drejtësisë. Si po ecën?**

Gjërat po përparojnë mirë, veçanërisht me procesin e ri të vlerësimit të gjyqësorit. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Shqipërisë në nivele të ndryshme po kalojnë nëpër një proces verifikimi. Ky proces i ri po vendos gjithashtu një shembull për vendet e tjera në rajon, veçanërisht pasi BE po fillon

një procedim disiplinor kundër shteteve anëtare për shkeljet në sundimin e ligjit dhe të standardeve të drejtave të njeriut. Po ashtu krijon një precedent për vendet që ashtu si ne, janë në rrugën e anëtarësimit. Është një reformë e madhe dhe po shkakton një situatë të vështirë, sepse largimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk kalojnë testin e verifikimit është duke krijuar një vakum në ato institucione. Në këtë drejtim, duhet të përqendrohemi në

forcimin e burimeve njerëzore kur bëhet fjalë për nivelin më të larta të gjyqësorit dhe prokurorisë. Në besojmë se këto reforma do të kenë një efekt domino edhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

**Le të kthehemi në rajon. Evropa Juglindore ka shënuar përparim të konsiderueshëm, siç tregohet edhe nga anëtarësimi i saj në NATO dhe anëtarësimi i mundshëm në Bashkimin Evropian. Cilat janë sfidat e mbetura?**

Së pari, është e rëndësishme të sigurohet se ka angazhim të SHBA-ve në rajon. Shtetet e Bashkuara janë të rëndësishme për garantimin e sigurisë në Evropën Juglindore. Së dyti, është gjithashtu e rëndësishme të sigurohet një ndarje e punës midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian kur është fjala për transformimin e rajonit tonë.

**Çfarë përparimi mund të bëhet midis Serbisë dhe Kosovës?**

Së pari, duhet të shohim disa rezultate politike nga procesi i pages. Tani për tani, fokusi kryesor ka qenë në çështjet teknike në lidhje me lejet e drejtimit dhe lëvizjen e qytetarëve në zonat kufitare. Ka ardhur koha për Serbinë dhe Kosovën që të bëjnë lëshime më të dhimbshme dhe me shpresë të arrijnë një marrëveshje reciprokisht të dobishme, e cila gjithashtu mund të jetë ligjërisht e detruarshme. Është shumë e qartë se për Serbinë nuk ka pranim në BE pa njohjen e Kosovës. Për Kosovën nuk ka rrugë drejt BE-së apo NATO-s pa adresuar çështjet që kanë të bëjnë me Serbinë apo pak-



Ministri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati dhe zëvendës-presidenti Ekzekutiv i Këshillit Atlantik, Damon Wilson



icën serbe në Kosovë.

**Cili ka qenë reagimi juaj ndaj mundësisë për shkëmbim territoriale midis dy vendeve?**

Mendoj se kjo do të shkonte kundër frymës së të gjitha përpjekjeve të bëra në Ballkan gjatë tri dekadave të fundit. Do të shkonte kundër frymës së Aktit Final të Helsinkit dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare me vlerë ligjore. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos hapim kutinë e Pandorës për raste të tjera në rajon. Shtetet e Bashkuara, BE dhe NATO kanë investuar shumë në promovimin e multietnicitetit të Ballkanit, për të siguruar që shoqëritë të mbeten të hapura. Unë e di shumë mirë se është një sfidë e vështirë për të ndërtuar shoqëri dhe institucione që i shërbejnë këtij qëllimi, por ne duhet të vazhdojmë në këtë rrugë.

Përcillet me homazhe në sallën e Kuvendit, ish-ministri i Mbrojtjes

## Xhaçka: Luan Hajdaraga drejtoi në vitet ku luhej fati i shqiptarëve

Rama; kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruci, ministra dhe kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi dhe shumë figura të tjera. Ndërkohë, pas homazheve të kryera në sallën e seancave plenare, ku ai ishte deputet për vite me radhë, Hajdaraga u përcill në banesën e fundit, ku trupi i tij do të prehet në varrezat e Tufinës. Në emër të kabinetit të tij, ngushëllimet i shprehu ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. "Nuk e mendoja kurrë që do të përcillinim kaq shpejt mikun dhe kolegun tonë. Hajdaraga kontriboi dhe drejtoi me aftësi të rralla institucione të arsimit dhe të shkencës shqiptare. Hajdaraga drejtoi



MM në ato vite të vështira ku luhej fati i shqiptarëve, fati i Kosovës. Luan Hajdaraga është një rast i rrallë ku bashkohen në një të vetëm profesori, shkencëtar, politikani, legjislatori dhe shtetari. Do ta

kujtojmë si bashkëthemelues dhe nënkryetar i PS në kohët më të vështira", u shpreh Xhaçka. Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi u përlot teksta kujtosi vitet e bashkëpunimit. Për të, Hajdaraga solli ndryshimin e PS. Presidentit Meta vlerësoi përkushtimin në punë, duke thënë se ishte mendohapur. Kreu i shtetit ka bashkëpunuar me Hajdaragën në nisjen e karrierës së tij politike. Edhe kryeministri Rama ndërroi me homazhe Hajdaragën. Figura e Luan Hajdaragës u vlerësua edhe nga kreu i BDI në Maqedoni, Ali Ahmeti, i cili tha se ai ka qenë krah shqiptarëve të Maqedonisë.



Kryeministri flet për teatrin: Do bëjmë të ri, sot është thjesht ngrehinë e vdekur

# Rama: Ofertë të re për opozitën në shtator, por nuk i ofrojmë pushtetin

## "Presim lajm të mirë nga SHBA për mbrojtjen së shpejti"

**K**ryeministri Edi Rama tha dje se në shtator mund të ketë një bashkëpunim me opozitën. Në një intervistë për gazetarin Lufti Dervishi në emisionin "Përballë" në RTSH, kreu i qeverisë tha se e vetmja gjë që nuk mund t'i ofrojë Partisë Demokratike dhe LSI-së është pushteti. "Të tjerat janë të gjitha për diskutim. Nuk kemi asnjë problem", është shprehur kryeministri Rama. "Jemi duke përgatitur një platformë bashkëpunimi, që do ta bëjmë publike me fillimin e sezonit të ri parlamentar dhe jemi të gatshëm për çdo propozim të opozitës që nuk na kthen mbrapa", tha Rama.

**Ju e pranuar që ishte vit i vështirë. Cili ka qenë momenti më i vështirë për ju si kryeministër?**

Momenti më i vështirë ka qenë momenti kur u gjendëm përballë faktit se nuk ishim të përgatitur si duhet dhe nuk kishim bërë punën e duhur për të mundësuar fillimin e procesit të pagësës për Rugën e Kombatit dhe...

**... protesta e Kukësit**  
Edhe aty... nuk është çështja te protesta, por është çështja te fakti që ne nuk bëmë si duhet detyrën tonë.

Në këtë rast kishte një moskuptim të realitetit, një shkëputje nga realiteti se si jetojmë njerëzit, një tarifë krejt e papërbalueshme për atë zonë. Cili është mësimi i madh që nxorët nga ky rast?

**Mësimi i madh ishte që nuk duhet asnjëherë t'i marrim gjërat të mirëqena dhe duhet gjithmonë të jemi në sinkron me njerëzit në procesin e politikës. Pastaj sigurisht ka raste që duhet të marrësh vendime që mund të mos jenë...**

Vendimi i BE për negociatat.

**Tek e fundit a mbetet i kënaqur nga kompromisi i arritur?**

Patjetër që mbeta i kënaqur, sepse në fund fare procesi nuk është një provim për të marrë një certifikatë se kalove klasën në Bruksel apo Europë, procesi është një përpjekje e vazhdueshme për të ndërtuar këtu Shqipërinë europiane dhe në këtë aspekt procesi nuk ka ndalim, procesi ka vazhduar dhe nuk është asçfarë e thashë, është faza që pason çeljen formale të negociatave dhe kjo më ka bërë, na ka bërë, që të jemi të kënaqur me rezultatin.

**...ka disa faza që mund të zhdukën nëse ka vullnet politik, një prej tyre është që këshilli thekson se një dialog i qëndrueshëm dhe konstruktiv mes qeverisë dhe opozitës për reformën që lidhen me BE mbetet vendimtar për avancimin e axhendës së reformës në të mirë të qytetarëve dhe në afërsim e vendit me BE, pika 47. Procesi kërkon domosdoshmëri opozitën.**

Kjo frazë nuk do të zhduket për sa kohë nuk do të zhduket nga Partia Demokratike, hiqa e rëndë e së shkuarës dhe njëkohësisht, edhe paafësia alarmante për të kuptuar realitetin dhe për të nxjerrë mësim nga humbjet. Kështu që le të mos kemi asnjë



Kryeministri Edi Rama, dje në emisionin "Përballë"

iluzion në këtë aspekt, do të kemi në vijimësi këtë frazë deri kur të kemi një Parti Demokratike të reformuar dhe të gatshme për t'u sjellë si alternativë qeverisë dhe jo si alternativë muskuloze.

**Ju po flisni se çfarë duhet të bëjë kundërshtari, në këtë rast pyetja është: Çfarë mund të bëni ju si kryeministër?**

Unë dhashë përgjigje për frazën që... fraza thate është "në dorën tonë", nuk është në dorën tonë, është në disa duar, se përna na përket neve, kemi qenë dhe mbetemi të gatshëm për të bashkëpunuar me opozitën. Unë e kam treguar me fakte kokëforta. Dhe fakti më kokëfortë ishte shtrirja e dorës së bashkëpunimit për muaj të tërë ndaj opozitës për të garantuar procesin e kaluar zgjedhor dhe lufta për muaj të tërë ndaj kryetarit të opozitës dhe marrëveshja më në fund e arritur jo si nevojë dhe interes i ngushtë i drejtëdrejt politik, se po të ishte për interesin e drejtëdrejt politik, të ngushtë politik, nuk kishim marrëveshje me opozitën dhe kishim sot të gjithë parlamentin le të themi në dispozicion dhe askush nuk do të na thoshte plaçi, se ndërkohë goftë SHBA, goftë BE ia vunë vizën asaj mundësie të përfshirjes së opozitës dhe opozita sot, Partia Demokratike, do të ishte një forcë tërësisht e izoluar, por interesi i Shqipërisë dhe interesi i shqiptarëve e donte dhe për këtë arsye unë e bëra gjithë atë përpjekje dhe jam i gatshëm ta bëj gjithmonë këtë përpjekje. Mirëpo...

**Mund të përsëritet 'magjia' e 17 majit (2017-marrëveshja me opozitën)?**

Unë nuk mendoj se është e pamundur, por nga ana tjetër, siç e kemi parë dhe siç e kanë parë të gjithë, opozita është pa leadership, pa vizion, pa strategji, pa program dhe ecën kulturë pa menduar për hapin e tretë, të katërt, të pestë. Pra, pavarësisht se ishte një mënyrë e mirë për të krijuar një eksperiençë dhe për të mësuar shahun, Luzlim Basha ka mbetur...

**Një nga kauzat publike të opozitës për javët e fundit ka qenë lidhja për teatrin. Jeni të gatshëm që në këmbim të ligjit për teatrin të merrni për shembull ligjin për shkollën e magistraturës?**

Jo, sepse nuk ka asnjë lidhje.

**Pse është "Jo"-ja juaj kaq e shpejtë në këtë rast?**

Në këtë rast kishte një moskuptim të realitetit, një shkëputje nga realiteti se si jetojmë njerëzit, një tarifë krejt e papërbalueshme për atë zonë. Cili është mësimi i madh që nxorët nga ky rast?

**Zoti kryeministër a keni ju një ofertë për opozitën, që ajo të bëhet pjesë e procesit, sepse shumë gjëra duhet të bëhen bashkë me të, vijueshmëria e reformës në drejtësi, ligji për magistraturën, keni një ofertë për opozitën që të integrohet...**

Unë e vetmja gjë që nuk mund t'i ofrojë Partisë Demokratike dhe simotërës së saj LSI është pushteti. Të tjerat janë të gjitha për diskutim. Nuk kemi asnjë problem. Jemi duke përgatitur një platformë bashkëpunimi, që do ta bëjmë publike me fillimin e sezonit të ri parlamentar dhe jemi të gatshëm për çdo propozim të opozitës që nuk na kthen mbrapa, rikthim mbrapa te reforma në drejtësi, rikthim mbrapa te ligjet e reformës në drejtësi, rikthim mbrapa tek ligji vetingut nuk ka për të pasur, për sa kohë që do të jemi në krye të këtij vendi. Ndërsa...

**Një nga kauzat publike të opozitës për javët e fundit ka qenë lidhja për teatrin. Jeni të gatshëm që në këmbim të ligjit për teatrin të merrni për shembull ligjin për shkollën e magistraturës?**

Jo, sepse nuk ka asnjë lidhje.

**Pse është "Jo"-ja juaj kaq e shpejtë në këtë rast?**

Në këtë rast kishte një moskuptim të realitetit, një shkëputje nga realiteti se si jetojmë njerëzit, një tarifë krejt e papërbalueshme për atë zonë. Cili është mësimi i madh që nxorët nga ky rast?

**Zoti kryeministër, doja të ndërrojmë temën dhe të kthohemi në vizitën tuaj në Bruksel, jo më për çështjet e BE-së, por për çështjet e NATO-s. Debatu i fokusua shumë të kërkesa këmbëngulëse e Presidentit të SHBA-ve që buxheti për mbrojtjen të shkojë deri në 4%, por angazhimi në NATO është të pakten 2%. A do t'i përmbahet Shqipëria angazhimit që buxheti për mbrojtjen deri në vitin 2024, në mos gaboj, të jetë 2% e GDP-së?**

Patjetër. Shqipëria është në pozicion pozitiv edhe në raport me këndvështrimin e administratës amerikane dhe patjetër... Unë shpresoj që së shpejti të kemi një lajm shumë të mirë për marrëdhëniet tona me Shtetet e Bashkuara në pikëpamje të mbrojtjes. Nuk mund të them më shumë, por ajo që është kryesorja është që...

**Lajmi mirë në fushën e mbrojtjes do të thotë interes për bazë...**

Ne kemi një ecuri shumë pozitive në këtë proces. Nuk mund të them më shumë.

**Vjet kur keni njoftuar kabinetin qeveritar, keni thënë: Mandati nuk është as i përjetshëm, as i pakufizuar. Pas një muaji i që është muaji i pushimeve, do të mjaftojë në shtator periudha e pushimeve për një kabinet të freskët, apo është koha për bilanc dhe për rifreskime?**

Ne kemi futur një sistem të ri në procesin qeverisës, që është sistemi kontratave të performancës së ministrave, të zëvendësministrave. Po shtrihet edhe në agjencitë kryesore dhe është një proces që e objektivizim performancën e gjithësej, sepse ka objektiva, ka parametra me të cilat matet etj., etj. Dhe para pak ditësh kemi bërë një analizë të kontratave të performancës, kemi disa objektiva të gushtit për të cilat do të diskutojmë në fund të muajit, pasi të gjithë të kenë marrë kohën për të bërë përgatitjet e nevojshme dhe pastaj do të shikojmë se si do të hyjmë në vitin tjetër politik, pra në shtator, që do të jetë një vit intensiv për shumë arsye.

**...do të hyni vetëm në zgjedhje, apo do të kërkonit aleatë?**

Të thellojmë fitoret... Thashë, në aleancën e kemi me qytetarët dhe e kemi reale. E kemi dëgjuar gjithmonë këtë aleancë me qytetarët, aleanca me qytetarët. Ne aleancën e kemi me njerëzit dhe duam ta bëjmë sa më të prekshme dhe sa më reale.

cia e së shkuarës për të shkuar e për të parë shfaqje, sepse dihet se në çfarë kushtesh zhvillohet jeta aty.

**Zoti kryeministër, doja të ndërrojmë temën dhe të kthohemi në vizitën tuaj në Bruksel, jo më për çështjet e BE-së, por për çështjet e NATO-s. Debatu i fokusua shumë të kërkesa këmbëngulëse e Presidentit të SHBA-ve që buxheti për mbrojtjen të shkojë deri në 4%, por angazhimi në NATO është të pakten 2%. A do t'i përmbahet Shqipëria angazhimit që buxheti për mbrojtjen deri në vitin 2024, në mos gaboj, të jetë 2% e GDP-së?**

Patjetër. Shqipëria është në pozicion pozitiv edhe në raport me këndvështrimin e administratës amerikane dhe patjetër... Unë shpresoj që së shpejti të kemi një lajm shumë të mirë për marrëdhëniet tona me Shtetet e Bashkuara në pikëpamje të mbrojtjes. Nuk mund të them më shumë, por ajo që është kryesorja është që...

**Lajmi mirë në fushën e mbrojtjes do të thotë interes për bazë...**

Ne kemi një ecuri shumë pozitive në këtë proces. Nuk mund të them më shumë.

**Vjet kur keni njoftuar kabinetin qeveritar, keni thënë: Mandati nuk është as i përjetshëm, as i pakufizuar. Pas një muaji i që është muaji i pushimeve, do të mjaftojë në shtator periudha e pushimeve për një kabinet të freskët, apo është koha për bilanc dhe për rifreskime?**

Ne kemi futur një sistem të ri në procesin qeverisës, që është sistemi kontratave të performancës së ministrave, të zëvendësministrave. Po shtrihet edhe në agjencitë kryesore dhe është një proces që e objektivizim performancën e gjithësej, sepse ka objektiva, ka parametra me të cilat matet etj., etj. Dhe para pak ditësh kemi bërë një analizë të kontratave të performancës, kemi disa objektiva të gushtit për të cilat do të diskutojmë në fund të muajit, pasi të gjithë të kenë marrë kohën për të bërë përgatitjet e nevojshme dhe pastaj do të shikojmë se si do të hyjmë në vitin tjetër politik, pra në shtator, që do të jetë një vit intensiv për shumë arsye.

**...do të hyni vetëm në zgjedhje, apo do të kërkonit aleatë?**

Të thellojmë fitoret... Thashë, në aleancën e kemi me qytetarët dhe e kemi reale. E kemi dëgjuar gjithmonë këtë aleancë me qytetarët, aleanca me qytetarët. Ne aleancën e kemi me njerëzit dhe duam ta bëjmë sa më të prekshme dhe sa më reale.

Permbareuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :  
a) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 582/1, vullmi 10, Faza 248, në zonën kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër  
b) Tokë are e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 523/21, vullmi 9, Faza 3, në zonën kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3260 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër, Z. Qmimi me të cilin do të fitojë shitja në Ankand për pasuritë e sipërpërkthuar, është në vlerën a) Për pasuritë "Toka Are" me sip 3230 m<sup>2</sup>, është në vlerën 439,538 leke  
b) Për pasuritë "Toka Are" me sip 2360 m<sup>2</sup>, është në vlerën 321,148 leke  
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 08.08.2018 ora 16:16 në Zyrën e përmbareut gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballe Gjykatës së rehit Gjyqësore Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdritin përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051.



**Kreu i qeverisë: Në shtator lançojmë reformën e re "Bashkimin e pronës"**  
Kryeministri i vendit, Edi Rama deklaroi dje në një takim me koordinatorët e bashkëqeverisjes në Kryeministri se në muajin shtator do të lançohej platforma dixhitale, e cila do të bëjë të mundur dhënien e titullit të pronësisë më shpejt nga ç'është bërë deri më tani. Sipas Ramës, risi e kësaj reforme është mundësia e apelimit brenda institucionit pa qenë nevoja të shkohet në gjykatë. "Tashmë fillon një hetim administrativ, nëse vonesa është e lidhur me korrupsionin, apo rryshfetat. Kur kjo verifikohet, meren masa dhe pastrohet administrata, rritet dhe vetëdija e atyre që punojnë në këto administrata. Sot është dita e fundit e një viti intensiv qeverisës, pasi meser fillojnë pushimet. Pavarësisht nga dy apo tri javët e pushimeve, zyrat do vazhdojnë të funksionojnë. Kjo është një punë që mund të bëhet nga çdo pikë. Kushdo që do kërkojë ndihmë nga ne, do ta gjeje atë", tha dje Rama. Kryeministri vuri theksin tek legalizimet, për të cilat tha se kushdo që ka bërë një kërkesë në zyrën e hipotekës, ka marrë përgjigje brenda afatit të caktuar dhe nuk është detyruar që të presë për një periudhë të gjatë kohore, siç ndodhte më përpara. "Kemi ende shumë për të bërë. Në shtator jemi gati të lançojmë reformën për të cilën jemi zotuar, "Bashkimin e pronës", tha Rama.

Gentian Osmani, një nga gjashtë prokurorët që po hetojnë Tahirin, drejt konfirmimit

Ina Allkanjari

Vetingu skualifikoi ditën e djeshme nga radhët e sistemit të drejtësisë, anëtarin e Gjykatës së Lartë, Artan Brocin. Vendimi për shkarkimin e tij u mor pas një hetimi administrativ disamujor dhe zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi t'i ndërprejë karrierën gjyqtorit, me arsyetimin se ai nuk justifikon pasurinë.

#### HETIMI

Gjatë seancës dëgjimore Broci u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, pasuria e Artan Brocit rezultoi me probleme. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Valbona Sanxhaktari, Etleda Çiftja e Xhensila Pine dha vendimin e marrë me shumicë votash, 3-0 pro shkarkimit të Brocit. Në seancë Shehu u njoh me rezultatet e hetimit në të tria shtyllat e procesit të rivlerësimit pasurisë, figura morale dhe aftësitë profesionale. Gjatë hetimit të thelluar, KPK konstatoi se Artan Broci ka probleme me shtyllën e pasurisë, pasi ka rezultuar me mospërputhje çmimesh për një apartament që ka blerë dhe ka shmangur taksat. Subjekti u mbrojt duke u shprehur se ka paguar detyrimet, por zyra e tatimeve nuk jep të dhënat. Përsa i përket figurës së gjyqtarit, DSIK dorëzoi një raport pozitiv, duke deklaruar se është i pastër, ka aftësi të zbatuesë të ligjit dhe nuk ka kontakte me njerëz të krimt. Pas vendimit për shkarkimin e tij, përmes një deklarate për mediat, Broci e cilësoi KPK-në si komisarët politikë të kryeministrit Edi Rama, që sipas tij nuk dolën dot nga urdhrat politikë. Ai theksoi se kishte provuar se të ardhurat e tij ishin të ligjshme, ndërsa paralamjëroi se beteja e tij ligjore do të vazhdohej deri në fund. "KPK si komisarët politikë të kryeministrit nuk dolën dot nga urdhrat politikë. U provova se të ardhurat e mia janë të ligjshme, të konfirmuara nga Tatimet, kalova në pikëpamjen time të tri testet: pasuror, profesional dhe figurën, por nuk kalova dot testin e nënshtrimit për çështje të caktuara dhe atë të kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Beteja ime ligjore do vazhdojë deri në fund", u shpreh gjyqtari Broci. Artan Broci e nisi karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 1996 si gjyqtar në Gjykatën e Tiranës. Ai e ushtroi funksionin pranë kësaj gjykate deri në vitin 2010, kur u promovua në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Në prill të vitit 2013, Broci u dekretua anëtar i Gjykatës së Lartë. Paralelisht me detyrën si gjyqtar, Broci ka qenë edhe asistent-pedagog në Fakultetin e Drejtësisë si

# Vetingu, shkarkohet anëtarin e Gjykatës së Lartë, Artan Broci

Gjyqtari: Komisarët politikë të KPK s'dolën dot nga urdhrat e Ramës



Anëtarin e Gjykatës së Lartë, Artan Broci

#### KONSTATIMI

KPK konstatoi se Artan Broci ka probleme me shtyllën e pasurisë, pasi ka rezultuar me mospërputhje çmimesh për një apartament që ka blerë dhe ka shmangur taksat. Subjekti u mbrojt duke u shprehur se ka paguar detyrimet, por zyra e tatimeve nuk jep të dhënat.

#### MEDI BICI

KPK konfirmoi në detyrë gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Medi Bicin. Gjyqtari ishte anëtarin i fundit i Gjykatës së Lartë që iu nënshtrua vetingut, ndërsa ai kandidon edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Komisioni kreu hetimin e tij të pavarur, pranë deklarata e Bicit iu nënshtrua një hetimi të thelluar ku u konsistua se ka vilë 4-katëshe, vendosur në truall 430 m<sup>2</sup>, ndërtaur gjatë 1993-1996. Gjyqtari ka paraqitur një deklaratë ku vëllai thotë se e ka ndihmuar për shkaqe veshitërisë financiare. Subjekti ka paraqitur prova për këtë gjë.

#### GENTIAN OSMANI

Ditën e djeshme KPK zhvilloi seancën dëgjimore për prokurorin pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Gentian Osmani. Osmani ka qenë një nga gjashtë prokurorët që po hetojnë ish-ministrin Saimir Tahiri për korrupsionin dhe trafikim lëndësh narkotike. Sipas KPK-së, Osmani ka qenë bashkëpunues duke dorëzuar dokumentet dhe deklarimet në kohën e parashikuar. Nga konstatimet e bëra rezultoi se Gentian Osmani nuk ka fshëjtë të pasurisë. Ndërkohë, DSIK ka dorëzuar një raport me konstatimin se Gentian Osmani është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

#### DRITAN RRESHKA

KPK shkarkoi nga detyra kreun e Komanduar të Prokurorisë së Tiranës, Dritan Rreshka. Në raportin e trupës gjyqësore thehjet se ILDKPKI raportonte se subjekti ka probleme sa i përket justifikimit të pasurisë. Prokurori i Tiranës, Dritan Rreshka e konsideroi të njëanshëm raportin e ILDKPKI. Në 2015, kur drejtohte Prokurorinë për Krime të Rënda, ai deklaroi se ka hetuar zyrtarë të këtij institucioni për veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.

#### ARTUR MALAJ

KPK doli kundër DSIK për gjykatësin e Apelit Administrativ, Artur Malaj. DSIK e konsideronte të papërshtatshëm Malajn për të vijuar ushtrimin e detyrës, pasi ishin zbuluar lidhje të tij me elemente kriminale. Në raportin e këtij institucioni thehjet gjithashtu se ka dyshime se Malaj është përfshirë në afëra korruptive gjatë kohës që ushtronte detyrën e kryetarit të gjykatës në Vlorë. Komisioni tha se pasi administratori dosjet gjyqësore dhe i shqyrtoi ato, arriti në përfundimin se raporti i DSIK ishte i paplotë dhe i pabazuar.

dhe anëtarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ai është angazhuar si ekspert në disa projekte si dhe ka dhënë kontribut në reformën e drejtësisë për të miturit në Shqipëri.

**PROKURORI I ÇËSHTJES TAHIRI**

Ditën e djeshme KPK zhvilloi seancën dëgjimore për prokurorin pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Gen-

tian Osmani. Osmani ka qenë një prej prokurorëve që kërkoi arrestimin e ish-ministrit Saimir Tahiri për korrupsionin dhe trafikim lëndësh narkotike. Gjatë seancës relatori i çështjes, Roland Iia tha se lidhur me pasurinë, ILDKPKI ka dorëzuar një raport me konstatimin se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin. KPK ka kryer një

hetim të thelluar në lidhje me gjendjen pasurore dhe burimet e kësaj pasurie. Sipas KPK-së, Osmani ka qenë bashkëpunues duke dorëzuar dokumentet dhe deklarimet në kohën e parashikuar. Nga konstatimet e bëra rezultoi se Gentian Osmani nuk ka fshëjtë të pasurisë. Ndërkohë, DSIK ka dorëzuar një raport me konstatimin se Gentian Osmani

është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Vendimi për Gentian Osmanin do të jepet më 2 gusht.

#### SEANCA

Gjithashtu, KPK konfirmoi në detyrë gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Medi Bicin. Gjyqtari ishte anëtarin i fundit i Gjykatës së Lartë që iu nënshtrua vetingut, ndërsa ai kandidon edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor.



Plagosja në qendër të Korçës, lidhet në burg Gazmend Agolli

Gjykata e Korçës caktoi ditën e djeshme masën e sigurisë arrest me burg për 48-vjeçarën Gazmend Agolli. Ai akuzohet se qëllon me armë të shtunën 38-vjeçarën Erjon Hoxhallari. Për personin tjetër të përfshirë në konflikt, Daniel Morava, gjykata sipas kërkesës së prokurorisë, caktoi masën e sigurisë detyrim paraqitje. Të njëjtën masë sigurimi personal dha gjykata edhe për Erjon Hoxhallarin, i cili mbeti i plagosur nga të shtënat e Gazmend Agolli. Kujtojmë se përplasja ka ndodhur në qendër të qytetit të Korçës, ku ish-punonjësi i policisë ka qëlluar me armë zjarri mbi Hoxhallarin, ndërsa ka tentuar të qëllojë edhe një person, por ky i fundit u ka shpëtuar plumbave. Policia e Korçës ka shkruar menjëherë në vendngjarje dhe ka vënë në pranga 49-vjeçarën Agolli. "Arrestimi i tyre u bë, pasi në lagjen nr. 7, në rrugën 'Floresha Myteveli', dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasi Gazmend Agolli ka plagosur me armë zjarri pistolatë shtetasin Erjon H., i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Arma e zjarrit u gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale shtetasit Daniel Morava", thehjet në njoftimin e policisë.

Në sitën e vetingut kaloi ditën e djeshme edhe gjyqtari i Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj. Ai doli në seancë dëgjimore para trupës së gjyqtarëve Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të përbërë nga Genta Tafa Bungo, Pamela Qirko dhe Stela Zhegu, pasi vetohet me përparësi për shkak të kandidimit në Këshillin e Lartë të Gjyqësorit. Në lidhje me pasurinë e tij, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive vlerësoi se Hallunaj ka bërë deklaram të saktë dhe se ai nuk ka fshëjtë pasurie apo ndonjë deklaram të rremë. Ndërsa nga hetimi i thelluar rezultoi se gjyqtari Hallunaj ka në pronësi një apartament 165 m<sup>2</sup> të blerë me kredi për vlerën e 49 mijë eurove në 2005. Gjyqtari shpjegoi se rasti ishte okazion për shkak të veshitërisë financiare të ndërtesës. Ndërsa sipas raportit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, Hallunaj nuk ka kontakte të papërshtatshme. Gjithashtu, konstatohet përshtatshmëri për vijimin e detyrës.



## RRITJA E PENSIONEVE SHEMBUJT KONKRETË

Vendimi i qeverisë/ Sa do të jetë shtesa minimale dhe maksimale për një muaj

# Rritje pensionesh për 730 mijë pensionistë, kush përfiton

Sa do të marrin ushtarakët, minatorët e të moshuarit

Voltiza Duro

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, prej datës 1 korrik, rreth 730 mijë pensionistë në mbarë vendin përfitojnë rritje pensioni me 2.8%. Janë disa kategori që iu lind e drejta për të marrë një pagesë më të lartë pensioni. Të gjithë ata individë që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension për nënat me shumë fëmijë (të gjitha pensionet afatgjata që jep skema e sigurimeve shoqërore) e përfitojnë këtë indeksim prej 2.8%. Rritjen e pensionit e përfitojnë edhe disa skema si: skema trajtimit financiar të ushtarakëve; skema e ish-punonjësve të nëntokës, pra minatorët; skema e pensioneve suplementare të punonjësve të lartë të shtetit etj.

Masa e rritjes është mbi masën e përfitimit, pra llogaritjet bëhen nëpërmjet indeksimit të thjeshtë aritmetik. Edhe këto skema janë të informatizuara pranë ISSH dhe shtesat janë marrë nga ana e pensionistëve prej 1 korrikut 2018. "Gazeta Shqiptare" publikon sot për të gjithë të moshuarit masën e shtuar të përfitimit, bazuar në pagesën aktuale të pensionit. Sipas vendimit të qeverisë, shtesa minimale kap shifrën prej 369 lekësh të reja në muaj, ndërsa shtesa maksimale arrin në 980 lekë, kjo bazuar në masën e pensionit. Pra, sa më e lartë edhe shtesa e përfituar pas indeksimit me 2.8%. Kështu po japim disa shembuj të influencave të rritjes mbi masat e pensioneve, të cilat ndahen në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë



Foto ilustruese

pensionet stok të llogaritura deri në 1 janar të vitit 2015 e më përpara, ndërsa në grupin e dytë futen pensionet e llogaritura pas 1 janarit 2015-të e deri më sot. Nëse marrim një masë pensioni minimal të llogarituar para 1 janarit 2015, masa para indeksimit ishte 13563 lekë, ndërsa me aplikimin e rritjes, i bëhet një shtesë prej 369 lekësh, pra këtij pensioni minimal stok. Ndërkohë,

pensionit maksimal prej 27126 lekë i shtohet një vlerë prej 739 lekësh. Pensioni i fshatit që ishte 9071 lekë shtohet me 247 lekë, pra janë influencat që marrin pensionet gjatë procesit të indeksimit.

### KOMPENSIMI I TË ARDHURAVE

Pensionet e llogaritura para vitit 2015 marrin edhe një kompensim të ardhurash. Ky kompensim përfaqëson përfaqësimin e vet. Pra, 2.8% i

## 2.8%

### INDEKSIMI

Të gjithë ata individë që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension për nënat me shumë fëmijë (të gjitha pensionet afatgjata që jep skema e sigurimeve shoqërore) e përfitojnë këtë indeksim prej 2.8%.

rimin e pensionit minimal për ta çuar pranë pensionit mesatar, pasi ky i fundit në 2017-ën ishte 15527 lekë, i realizuar nga pensionet e reja të lidhura. Po të marrim pensionin minimal prej 13000 lekësh, i shtohet kompensimi për ta përfaqësuar me pensionin mesatar. Pra, kompensimet e bëra me vendime specifike të Këshillit të Ministrave për të përfaqësuar tendencën e pensionit minimal, pra për ta përfaqësuar me pensionin mesatar janë të kësaj natyre. Pas 1 janarit të 2015-ës, ka ndryshuar mënyra e llogaritjes së pensioneve dhe ka bërë që të hiqet tavanin e pensioneve në përlogaritje. Edhe kjo kategori pensionesh e ndjen rritjen pasi pëson rritje pensioni social. Nëse ky i fundit ka qenë 7100 lekë, ai pas indeksimit shkon rreth 7300 lekë dhe kur bashkohet me pjesën e llogarituar të pensionit jep influencën e vet. Pra, 2.8% i

indeksimit ndihet edhe për pensionet që do të lidhen pas korrikut 2018. Nëse u referohemi disa masave të pensioneve të llogaritura pas janarit të 2015-ës e deri më sot, shikojmë se nëse individë ka një masë pensioni prej 17000 lekësh do të marrë një shtesë prej 446 lekësh e tashmë masa do të shkojë 17446 lekë. Ndërsa, një pension prej 20000 lekësh, duke u rritur shkon 20560 lekë, shtesa është 560 lekë të reja, ndërkohë një individ që ka një masë pensioni prej 25000 lekësh, do të marrë 25700 lekë. Një masë pensioni prej 30000 lekësh pas indeksimit shkon 30840 lekë, ndërsa ai pension prej 35000 lekësh do të shkojë 35980 lekë në muaj, pra ka një shtesë prej 980 lekësh.

### INDEKSIMI APO RITJE REALE E PENSIONEVE?

Indeksimi i pensioneve me 2.8% përfaqëson rritje

pensionit, por realisht është indeksim, pra një detyrim i Këshillit të Ministrave për të indeksuar masën e pensioneve, të atyre që janë gjendje dhe të pensioneve të reja që priten të lidhen. Duhet të kuptohet se indeksimi është një tregues, një koeficient që mbron pensionet nga ajo që quhet "gërryerja" e përditshme e inflacionit. Ky indeksim me 2.8% ka qenë mbi nivelin e inflacionit. Por për të shkuar te termi rritje duhet t'u referohemi mundësive financiare që ka buxheti i shtetit, pasi ky i fundit përballon çdo ndryshim që bëhet në masën e pensioneve. Ky fond varion nga 1.8 miliardë lekë dhe është goxha i konsiderueshëm për skema të tilla e buxhete të tilla për Shqipërinë. Vetëm numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit, të parakohshëm, të reduktuar, pra të përfshirë në skemën 7803, arrin në 630 mijë persona ku aplikohet vendimi i indeksimit të pensioneve. Por nga kjo rritje do të përfitojnë edhe rreth 100 mijë individë të përfshirë në skemat e tjera. Pra në total, do të përfitojnë shtesën mbi pension rreth 730 mijë persona në mbarë vendin.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6.540.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 28 Gusht 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2.457.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 04 Shtator 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**ITALI** - Dhuna ndaj gruas së tij i ka kushtuar lirinë një 46-vjeçari shqiptar në Itali. Ai përfundoi në pranga, pasi tentoi të vriste nënën e fëmijëve të tij. Mediat italiane raportojnë se gjatë mbremjes së të hënës, policia e Materas u sinjalizua nga një telefonatë për konflikt në një familje. "Basilicata24.it"



## Parandalohet krimi në familjen shqiptare në Itali, 46-vjeçari tentoi të vriste gruan me thikë

shkruan se falë ndërhyrjes së policisë, u arrit të parandalohet krimi në familje. Mësohet se 46-vjeçari pas një shërri për motive banale kishte nisur të këqtrajtonte gruan e tij 36 vjeçe, në sy

të fëmijëve të tyre, 7, 14 e 15 vjeç, të cilët ishin bërë edhe dëshmitarë të skenës së rëndë. Shqiptari, me iniciatet C.A. nisi të godiste gruan dhe ta kërcënonte me vdekje, ndërsa më pas u për-

poq ta godiste atë me dy thika kuzhine. Pasi ndërhyri policia, u bë e mundur arrestimi i agresorit, ndërsa viktima e dhunës u dërgua në spital, pasi kishte marrë disa lëndime.

25-vjeçari do udhëtonte në Siri për të luftuar me një grup të lidhur me Al-Qaeda

# Planifikoi sulm terrorist në Australi, dënohet me 17 vite burg shqiptari

*Agim Kruezi u arrestua në vitin 2014 dhe u deklarua fajtor në Gjykatën Supreme të Brisbane*

Një australian me origjinë shqiptare është dënuar me 17 vjet burg të martën, për planifikimin e një sulmi terrorist në Australi, pasi u ndalua kur po përpjeqej të udhëtonte në Siri. Sipas TV "Klan", 25-vjeçari Agim Kruezi u arrestua në vitin 2014 dhe u deklarua fajtor në Gjykatën Supreme të Brisbane, për përgatitjen e akteve terroriste dhe planifikimin e një inkursionit të huaj. Në gjykatë u tha se Kruezi planifikoi të udhëtonte në Siri për të luftuar me një grup të lidhur me Al-Qaeda, por u ndalua nga oficerët e doganave dhe pasaporta e tij u anulua. Sipas "Daily Mail", policia gjeti një armë gjysmë automatike, dy maska, dy hanxharë, një fotokopje të një libri të quajtur Xhihad dhe një flamur të Shtetit Islamik në dhomën e tij të gjumit. Udhëzimet për të ekzekutuar prerje koke u zbuluan edhe në kompjuterin e tij dhe në ditët e para të arrestimit, ai bleu 10 litra benzinë dhe u përpoq të blinte shishe qelqi të përshtatshme për të bërë molotov.



25-vjeçari Agim Kruezi

Gjyqtarja Roslyn Atkinson tha se ishte e nevojshme që policia kundër terrorizmit ta arrestonte atë për të parandaluar një sulm publik. "Ishte i planifikuar deri në pikën që të grumbullonit armë -

tha ajo. - Nuk ka dyshime se keni pasur për qëllim kryerjen e komplotit terrorist, megjithëse detajet e sakta ende duhet të qartësohen". Ajo shtoi se, "nuk ka dëshmi që keni ndryshuar pikë-

pamjet tuaja (ekstremiste)". Canberra po preket gjithnjë e më shumë nga ekstremizmi në rritje dhe qytetarët që iu bashkohen organizatave xhihadiste jashtë vendit, siç është Sh-



teti Islamik. Vendi miratoi ligje gjithëpërfshirëse kundër terrorizmit në 2014-ën, që përfshijnë bllokimin e xhihadistëve që të shkojnë jashtë shtetit. Autoritetet thonë se kanë

parandaluar 14 sulme terroriste në vitet e fundit. Disa të tjerë kanë ndodhur duke përfshirë rrethimin e vitit 2014 në një kafene në qendër të Sidneit, në të cilën u vranë dy pengje. *tvklan.al*

### SHKURT

#### Dhunohet në burg i dënuari Adriatik Lala

**FUSHË KRUIË** - Dhunë në burgun e Fushë-Krujës. Nga të dhënat paraprake dyshohet se një i dënuar është dhunuar në ambientet e këtij institucioni të vuajtjes së dënimit. Bëhet fjalë për Adriatik Lalën, i cili thuhet se është dhunuar nga policia. Po ashtu mësohet se ai ka hematoma në kokë dhe trup, ndërsa nuk dihet ende se si paraqitet gjendja e tij. Deri më tani nuk dihen rrethanat se si ka ndodhur ngjarja, ndërsa pritet që të tjera detaje të dalin në dritë.

#### Dhunon kushëririn, i djeg edhe shtëpinë

**GRAMSH** - Një 29-vjeçar nga Gramshi ka rënë në pranga, pasi akuzohet se pas dhunës së ushtruar ndaj kushëririn të tij, i ka vënë flakën banesës së këtij të fundit. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Alban Jonuzaj, banues në fshatin Lemnushë, për motive të dobëta është konfliktuar me kushëririn e tij, shtetasin E.J., 35 vjeç. Por ai nuk është mjaftuar me kaq, pasi i ka vënë edhe zjarrin banesës së këtij të fundit. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

#### Tentuan të kalonin kufirin, kapen 13 klandestinë

**KORÇË** - 13 refugjatë (mes të cilëve dy të mitur) u kapën dje në Kapshticë, pasi po tentonin të kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme. Bëhet fjalë për 1 marokan, 5 palestinezë, 3 sirianë dhe 4 iranianë, ku disa prej tyre u ndaluan në fshatin Trestenik dhe pjesa tjetër në Kapshticë dhe Bllisht. Mësohet se të gjithë klandestinitë e kapur i përkasin gjinisë mashkullore. Burime pranë Drejtorisë së Policisë Kufitare të Kapshticës bënë me dije se refugjatët e kapur po përpjeqeshin të kalonin në mënyrë të parregullt kufirin shqiptar pranë Kapshticës. Pas marrjes së deklaratave, ata janë dërguar drejt qendrës së azilkerkuesve në Tiranë.

## Automjeti përplas motoçikletën, plagoset rëndë 28-vjeçari

**ELBASAN** - Një 28-vjeçar është plagosur si pasojë e një aksidenti që ka ndodhur mbrëmjen e së hënës në Elbasan. Mësohet se ngjarja ndodhi në aksin rrugor Elbasan-Metalurgji. Burime zyrtare nga policia vendore bënë me dije se "mjeti me targa EI 9956 A, me drejtues 28-vjeçarin me iniciale E.P., banues në lagjen 'Aqif Pasha' në Elbasan është përplasur me motoçikletën me targa AR 4897. Si pasojë e përplasjes është aksidentuar drejtuesi i motoçikletës dhe është transportuar në Spitalin e Elbasanit në gjendje të rëndë. Ndërkaq, drejtuesi i mjetit është shoqëruar në ambientet e Komisaritit të Policisë Elbasan për veprimet e mëtejshme. Grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit.



United Nations Development Programme



### VACANCIES ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidates who could fill the following consultancy vacancies.

**Posts Title:** Senior Local BPR Expert  
Quality Assurance Local Expert

**Duty station:** Tirana, Albania

**Type of Contract:** Individual Contract (IC), opened only for national experts

**For more details please see the links below:**  
[https://jobs.undp.org/cj\\_view\\_job.cfm?cur\\_job\\_id=80188](https://jobs.undp.org/cj_view_job.cfm?cur_job_id=80188)  
[https://jobs.undp.org/cj\\_view\\_job.cfm?cur\\_job\\_id=80264](https://jobs.undp.org/cj_view_job.cfm?cur_job_id=80264)

**Deadline for Application:** Senior Local BPR Expert, **07-Aug-18** (Midnight New York, USA)  
Quality Assurance Local Expert, **10-Aug-18** (Midnight New York, USA)

**Job Description:** Available at UNDP site:  
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.



Procedura që duhet ndjekur. Sa do të jetë sipërfaqja e tokës që do të marrë çdo familje

Voltiza Duro

# Lista me 1293 personat që kanë gati lejet e legalizimeve

*ALUIZNI: Ja emrat e përfituesve në Kamëz, Sarandë, Fier e Berat*

**A**LUIZNI publikon listën me 5000 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në Tiranë, Durrës, Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Kamëz, Kavajë, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Krutë, Sarandë dhe Fier. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e 1293 përfituesve për Fierin, Kamzën, Beratin dhe Sarandën. Drejtorja e ALUIZNI-t njofton qytetarët se duhet të paraqiten pranë zyrave të ALUIZNI-t për të tërhequr lejet ndërmorre. Ndërkohë që procedura për marrjen e tapisë do të ndiqen nga AULIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë. Kjo drejtori ka mbyllur të gjithë procesin për 5000 dosjet, të cilat tani kanë gati lejet dhe për pak ditë marrin certifikatën e

pronësisë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen për tërheqjen e saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasur-

ive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m<sup>2</sup>. Sipërfaqet mbi masat e për-

caktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me

shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish

dhe të depozituara brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përcës pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti. Ditën e nesërme "Gazeta Shqiptare" do të vijojë me publikimin e emrave të personave që kanë përfituar lejet e legalizimeve.

## LEJET E LEGALIZIMEVE

1104	ELISABETA LAMAJ	1343	GAZMENT DELIBASHI	1623	BARJAM KALLMI	473	ELIAN QAZIMI	1921	FERDINAND LUARI
	EDMIR LAMAJ	1639	KRENAR RUCI	1453	BILBIL DOSTI	4826	FJODERISA MBOLANI	1444	SOTIR GRAMATIKO
260	ELTON TAFILI	1466	KADRI SALAJ	118	AGIM PASHA	846	ILIRJAN QOLJA	28	NIKO NAKSI
1933	YMER HASANI	806	GEZIM GJISHTI	200	AGIM GJECI	4538	GEZIM TOSKA		SOKOL NAKSI
2294	AHMET ALAMETI	232	JANI MIMANIS		JULIAN GJECI	896	BARJAM RRIPI	5953	SOTIR GRAMATIKO
16	AJET VAVLA	547	HAJDAR METKAJ	1662	SANJJE DUCI	3415	LUTO CALA	6590	VASIL KATI
	ANA VAVLA	954	ARIAN KAFAZI		ERIDJOL DUCI	815	RONI ZHOPI	63	VLADIMIRZOGA
47	ARBEN KARAKASHI		IZOTA KAFAZI	1603	ZYDI KERPIKA	4811	ALEKS KOLA		KIMETE ZOGA
	LILI KARAKASHI	121	XHEMILE FIRAKU	987	REEAT GEGA	353	FERBENT ZHUKA	1385	GANI MINGU
1701	GEZIM LOPARI	108	PELIVAN SHEQERI	726	SEFER SENKA	331	LINDITA ISUFAJ	822	ILIR HOXHA
193	ALIT BAKU	439	NOVRUS KANANI		ELTON CEPELE		ARGITA LLANAJ	77	JOLANDA KECYRA
	DASHURI BAKU	5144	GENTIAN ÇAKO	1283	AVDYLL BRAMI		ANXHELA ISUFAJ		ANTEJOAS KELCYRA
500	LATIF FILE	88	AGIM TAMO	1766	FERAT ZANI		ELJO ISUFAJ		ARTJOL KELCYRA
	ARMANDO FILE	7545	ERMAL HAZIZAJ	1123	KRENAR PLAKU	6689	DULE KANACI	1438	AFERDITALESKAJ
1494	LEFTER CENOLLARI	277/5	ARSHIN RAMA	2097	KRISTO KOLA		LAVDIMIR KANACI	2430	EQEREM XHINDI
448	BESIM DELIBASHI	6293	BLENDAR AZIZI	1500	SHEPIT OSMANI	1128	LUAN BRAMI	775	ESMERALDO HAJDARASI
1851	BEDRI TOSKA	4662	MILTJADH NAÇO	764	ALITIN ZHOPI		MESTAN BRAMI		SHYQYRI HAJDARASI
386	FLORENC BENISHTA	5254	MYNYR HAZIZAJ	2823	GERALD SHYTI	736	FLORANT BANI	2240	EGLANTINDELIBASHI
3678	LEON BARDHI	6724	FATMIR HAZIZAJ	5952	EADIL OSHAFI		FATMIR BANI	2385	BUJAR HOXHAI
	HASAN BARDHI	5189	JANI HËNA		VALENTINA OSHAFI	3686	ELTON GEGA	7360	ZALO MUKA
1097	BLENDAR MIRAKAJ	971	VASIL PJETRI	201	QERIM BEJDO		ENTELE GEGA	2669	ENVER HOXHA
1135	XHEVAIR CIBUKU		ANASTASIA PJETRI	3501	DUSHI BREGU	439	REXHEP MOLLAJ	3351	ANDREA HOXHA
493	NANI DUCI	7829	KOMUNTTETIMUSLIMANI		LEVENT BREGU	277	ELMAS MURATAJ		LAVER HOXHA
	SADIK DUCI		SHQIPERISE,MYFTINIA BERAT	1157	SERJAN GAJTA	132	ILIR DINGO	6442	XHEVDET LUKAJ
107	MYRTEZA SHEQERI	6941	SHEZAI AZIZI	1472	ARTAN SELAMI	174	IDARIK ZHUKA	1649	LIAN XHINDI
833	KODHEL RAMO		SOPFJE BASHA	176	HAJDAR LIKAJ	436	KASTRIOTBAKUI		ARBRI XHINDI
189	EQEREM MIRAKAJ	3147	BILBIL HAZIZI	196	PELLUMB PLEPI	183	AGRON AGO	116	SULMOR KINCE
6948	GEZIM RIPAJ	883	ARJANA RAMO	7546	BILBIL HAZIZAJ	138	ALUSH BRAMI	147	ALITIN SPAHIU
275/14	GEZIM RIPAJ		FREDI RAMO	664	SALI ISUFAJ		VULLNET BRAMI		KASEM SPAHIU
	ILIR RIPAJ		FAJRE RAMO	932	RAMIS DOLLANI	6469	VLADIMIRPASMACIU		ALKETA SPAHIU
197	FATMIR SULO	1169	QETSOR HOXHA	6396	GEZIM BEJDO	589	ARDIAN BUBA		ERISELDA FEJZOLLARI
3441	VULLNET LOPARI		BATJAR HOXHA	4774	EATJON XHINDI	151	FIQIRI SADIKU	1811	KASTRIOTNANO
2510	SAIMIR ORIZI	611	ERJON OSHAFI	794	MARSELA XHINDI	196	ENEO HALITAJ	1378	ARTUR HASANAJ
	ABEDIN ORIZI		AHMET OSHAFI		EATJON XHINDI		BRAHIM HALITAJ	441	HYSNI XHINDOLI
996	AGIM MUCA	3265	BURAN MALASI		SABIRE XHINDI	83	MIKEL ISOLLARI		LIAN XHINDOLE
5192	VELI AVDIU	177	HAXHI MISIRI		SONILA XHINDI	416	JANULLA PAPA	120	NAMIK HOXHA
1841	BUKURLEJBREGU	5503	BASHKIM PLEPI		RAJMONDA XHINDI	2352	ILIR BRAMI	3257	KOSTA SAKAJ
	NAZMI BREGU	7543	KOSTANDIN QEMERI	4795	GRAMOS CALLMORI		ALUSH BRAMI	3517	MYQEREM SAKAJ
343	KRENAR BRAKA	1356	AVDULLA VRAPI	1102	MUHAREM KOKA	1814	FLAMUR MISHOVA		SHKELQIM SAKAJ
198	KRENAR RAMO	2255	JANI VOJKU	1449	PETRIT SULOVARI	6002	EDMOND OMERI	17	MYNYR ZEMA
1492	FATMIR HOXHAI		BARJE VOJKU	469	QAMIL FIKAJ		ARTA OMERI		JETNOR ZEMA
6134	LEFTER SHAMO		ISA VOJKU		SYBIE FIKAJ	457	SHEGE ZEQAJ	626	JANI LUSHKA
4221	KRISTO HAXHISTASA	770	IBRAHIM KRAPSI	6494	EMILJANO TOSKA		FLORESHA ZEQAJ		VULLNET LUSHKA
6640	ILJAZIM MYRTAJ	1445	ALI HASANAJ	1357	VASIL SALAJ		ARBEN ZEQAJ	16	MERSIN TOSKA
	MUSTAFA MYRTAJ	1402	ZENEL BEJDO	727	EDMOND SENKA		VULLNET ZEQAJ		YLLI TOSKA
1393	JULIAN SELAMI		LUTFLE BEJDO		FLORESHA SENKA	8	VEXHI HOXHA	6039	NAZMI SAKAJ
	ADEM SELAMI	814	HALIT SELAMI	1147	IZET MEMISHI	1445	VANGJEL GRAMATIKO		ISMAIL SAKAJ
886	SHABAN OSHAFI	1096	ALI DELIBASHI	1127	VALTER BRAMI	330	KLODIAN LAZAJ	7633	SIMON FERRO
2177	LAVDIMIR BEJDO	185	LEFTER DELIBASHI		MESTAN BRAMI	326	BUJAR MIMINI		VANGJEL FERRO
	TEFIK BEJDO	3037	BUJAR KALECI	1308	HYSNI BRAMI	894	ARTAN DINGO	7012	DILAVER CELA
117	ISA KOSOVA		ESAT KALECI	138	MEHMET ZYLFA		EDUARD DINGO		HYSEN CELA

2084	KRENAR AGALLIU	4466	PELIVAN KAPLLANI	BANUSH GJONI	ENKELEJDI BANI	ALBERT CUCURI
	ASIM AGALLIU	4672	SHPETIM PASHA	JULJAN KOTHERE	JAKOV BISHYTI	ANDREA GJECI
245	ADRIANA SALAJ	7879	VLADIMIRFANI	TELHA CEPELE	BESNIK HYSAJ	VANGJEL GJEKA
7111	NURI MYPTARI	2940	XHEZO HOXHA	FESTIM BERBERAJ	ANILDA AGALLIU	ARDIANA MBYETI
	MINUSHE MYPTARI	1274	LORENC PERDITA	ALBERT ZYKA	LEONARD GEGA	PAVLO XHEPAJ
2189	GEZIM OLLDASHI	3256	ALBAN KOÇIU	ALI AGACI	VASIL KOLA	MYQEREM ISUFAJ
	BRAHIM OLLDASHI	3900	RIZA SHANO	TOMORR METANI	ASIM MUHAJ	TAULANT SERJANAJ
452	SHKELQIM TOSKA	4272	SADIK METKAJ	MILTJAN HAZIJA	SHPETIM CEPELE	MYLAZIM KUKA
	FILE TOSKA	161	KASTRIOTRAMAJ	JAKO DRIZA	ROLAND MONE	RAHMAN BUZI
80	ROLAND VRAPI	2411	SHYQO XHINDI	ARTAN DYLAJA	XHEVDET AGOLLI	REFAT RAMAJ
182	HERRI MANCI	2232	XHAFER TABAKU	NOVRUS GROPSI	ARIONAL TOMORRI	SELIM ZAGRACI
	ARMANDO MANCI	68	AVDYL BEGA	ALTN DREKA	SULO KANAJ	NOLI RAMAJ
	ROLAND MANCI	564	KASTRIOTHYSA	BATO HYKA	SOTIR KOVE	LEONIDHA MICI
	LULZA MANCI	HYSNI CEPELE		HALIM DALIPAJ	MIRANDA DERVISHAJ	SEFRET MEHMETAJ
4272	SADIK METKAJ	MARKO CALA		ZANA HYKA	LLUKAN KOLA	JOTI VANGJEL SOTA
1359	NELI SELAMI	ILIR SENKA		AGRON SHUSHA	SETI BEHARI	DHIMITRAQ DIMO
	NEXHIP SELAMI	ARJAN HYKA		LUFTAR LAMAJ	MENE MEMIKO	MYSTEHAK BESNIK HYSANAJ
2574	ENVER KOÇIU	BASTRIT DRIZA		AGIM CEPELE	FLORIAN MISIRAJ	KUTJIM DILAVER MEMA
6713	HASAN ZYLALI	PELIVAN BUFI		LEFTER CEPELE	HABIL HOXHA	REFAT ERVEHE RAMAJ
5527	ENVER SINANI	PELLUMB TOSKA		NESTI NUSHI	ARJAN FESTIM LUTAJ	BILBIL BLEDI SINAJ
5805	ILMI BREGU	PETRO CELAS		FLAMUR CEPELE	YSEMT VELAJ	RAUF HARRUN HAXHIAJ
1452	LLAMBRO AGALLIU	LUAN SELAMI		RRAPI SHURDHA	SHPETIM NAZERAJ	AZBI LUGAJ
1934	KAMBER MBJESHOVA	LAVDIMIR METANI		ALBERT CEPELE	CLJIRM TROKA	ANISA CAUSHAJ
3287	DASHNOR KUCI	LUAN GODOLESHI		GEZIM VRAPI	HAMIT XHULAJ	SULEJMAN BEQO
505	FARI KANACI	VIKTOR KOTHERE		SMIAL KALEMI	KOZMA GJECI	NEIM GJATA
39	PETRO SHABANI	FATMIR NURKA		SHKELQIM BAXHIA	TAULANT ANGOLIN BIDA	REMZI AHMETI
477	NENTOR KEÇI	GENTIAN MANXHARAJ		AGRON HOXHA	FERDINANT TAULLA	FATMIR SHAHAJ
3284	KRENAR KALLUCI	LIRIM KALAJ		ASTRIT KACANIS	AGUR SEITAJ	ARTAN NURE
1488	MYFARETE LEKLI	REMZI SULO		TRIFON KINA	KADRI NAZERAJ	ISLAM KUKA
959	BAJRAM KEÇI	VERE AJDINAJ		BUJAR HOXHA	GEZIM TABAKU	BUJAR MURATI
4810	ROBERT PAPHATHMIU	GENCI MUSKAJ		ALBERT LAMCE	ALFRED PLAKA	HEKURAN SHKOPI
	HËNÇE PAPHATHMIU	LEONARD LULAJ		BILAL SENKA	NAMIK BUZI	ADRIATIK JAUPI
	SUELA PAPHATHMIU	ARJAN GREKU		TRIFON NUSHI	BILBIL GJECI	EDMOND HAJDARI
719	KLODJAN PLAKU	RASIM SELIMI		KOZMA MILE	RITO GEGA	ALEKS PRIFTI
	VULLNET PLAKU	VIKTOR ALIAJ		DRITAN VELMISHI	LUFTAR BUZI	ARTUR ZONJA
5648	FATOS DAULLJA	SKENDER BENDAJ		HEKURAN HOXHA	AGIM GERGOLLI	FILIP HAJDINI
	RAZIE DAULLJA	XHEVDET MUCAJ		SPIRO JANJI	ENVER LICAJ	THOMA MARKU
1167	ERJON AMATI	ARDJAN AVDIJA		THOMA KORDHISHTJE	LAVDERIM VRENOZI	PERIKLI PRIFTI
1110	REZARTA AGALLIU	YLLI LAZAJ		SHABAN ZOGA	BESHIR ARAPAJ	MEHMET SALIAJ
7879	VLADIMIRFANI	GRAMOS ILAJZI		FESTIM CAUSHAJ	BESNIK KLOTILDA ZARKA	PELLUMB MALIA
	LULJETA TAVANI	NAMIK CALAJ		LUTFI HAXHIU	ANDREA PRIFTI	ASIM SINAJ
3790	ROMEO BUHALI	FEJZI CALAJ		PELLUM ZYKA	NIKOLLAQ KOÇI	SHAQE BARJAMAJ
239	ELIDA KOMINI	LAVDOSH LAMCAJ		VASIL BANI	IZET ROBERT DASHI	FILIP XHOXHI
	KOSTANDIN KOMINI	ALI BEQAJ		AFRIM SELIMAJ	SOTIRAQ PROFKA	VANGJEL PRIFTI
	LUJDIAN KOMINI	NESHAT AGACI		ARBEN MISIRAJ	EDUART HALIM RUKO	ARBEN XHOXHAJ
	VANGJUSH KOMINI	ALKET MANE		NAZMI BAKAJ	BARDHYL LINDITA SANXHAKU	AGRON MONE
3	ROLAND KUQO	ERION ZEQRIRAJ		FAIK SELIMI	IRAKLI KOSTA	PETREF ALLAJ
	IRAKLI KUQO	ASLLAN ZYLALI		COMO BRAUSHI	HEKURAN SHEHAJ	QEMAL SHEHAJ
2693	RRAPO SEJATI	GANI PLAKA		LIMONETA VRENOZI	MUJEDIN JARUA	THOMA SHINDRE
15	LULI OLLDASHI	NOLIN DREKA		FREDI ZYKA	TAULANT NACI	NOVRUZ XEBA
3856	ANDON XHEKA	RAMSI KERRI		FTIM ZENUNAJ	PAJTIM KUMARAKU	ASTRIT LIKA
	KADRI XHEKA	ASQERI LIKAJ		TODI PEPA	SAJMIR HOXHA	JONI STANI
7386	FEJZI FILAJ	FLAMUR AGAJ		KRISTAQ XHOKAXHI	KASEM GREMBI	BEDI DURAJ
2990	SAIMIR SHANO	NAZMI FERZAJ		ALEKSANDER HILAJ	IDAJET HEBEJA	LUTFI HASTRIT GURGURI
	FETA SHANO	BEHAR TARAJ		SOKOL MALKA	ASTRIT SINAJ	FERIK ZOTO
6386	FESTIM SHANO	MYPTAR TARAJ		ARBEN TOSKA	LIAN GJOZI	SHKELQIM MUHAJ
6873	HAKI CELA	NAMIK ALIAJ		KASTRIOTLABRO	XHEVAIRE GOXHAJ	ALI KAMBERAJ
438	DILAVER MUSTAJ	SOKRAT ALEKSIU		ILIR BRACE	LLAZAR KOLA	FERDINANT SUBASHAJ
820	ERVEHE HOXHA	XHEMAL METUSHI		BEQAR HOXHA	BEHAR HALILI	MIRESI SINAJ
581	ISMET KABLO	JORGJI SEMA		SEFEDIN RASHLANI	HARILLA MINO	MARIGLEN PIPA
9	FLAMUR MUHAMETTI	LULEZIM HASAJ		JETMIR FETAU	DILAVER KADRIU	AGIM SMAKA
1790	HALIT KOÇIU	SHKELQIM GREMBI		LUTFI ARTAN JOAN DURMISHI	BAKI SERJANAJ	ANDREA DHANI
2303	ILIR SENKA	LULEZIM GJISHTI		AFRIM MUCAJ	ARBEN MUHO	GRAMOS MOLLA
2862	SHEFQET ZOGAJ	ROMEO SHUSHA		AGRON BARAJ	AGIM TERNOVA	SAMI MALOKAJ
21	RRAPO HOXHA	GENCI ASLLANI		FATJON DORTI	LILI DASHI	
3462	MYRTEZA RRIPI	ARBEN KOCAQI		NAZMI ISUFAJ	SAFERE BARO	1 GJYLKE ASLLANI
166	NAZIF PASHALLARI	AISHE SHERIFAJ		KRENAR ISUFAJ	MIRELI BENGASI	2 BAJRAM HIDA
1930	SYBI RAMAJ	TAULANT LULAJ		PELLUMB GREMI	FEJZO HOXHAJ	3 SHPETIM CANAJ
4690	KRENAR KOSOVA	BUJAR BRAUSHAJ		ADRIATIK KARAMANI	KRISTAQ PRIFTI	4 SEJDIJE BELLOVA
445	RUSHAN DERVISHI	MYNYR KOROVESHI		ALTN TOSKA	MIMOZA HOXHAJ	5 MEHMET SULI
2939	HYLMI HOXHA	VENDIM RIVAN HOXHAJ		AZEL KALLASHI	IRENA HOXHAJ	6 SEULEJMAN LILA
2586	MEHMET LLUPI	ASPASI DHANA		SHEFQET HAMOLLARI	DASHNOR XHEPAJ	7 ASLLAN ARUCI
2227	JORGO SAKAJ	GEZIM BUSHI		ISMAIL BLENDAR SOKOLDEMISHAJ	ARTUR MERKO	8 REXHEP JAH
2411	SHYQO XHINDI	HAZIS KOÇI		ARBEN SIMAKU	ILIR DIMO	9 VLADIMIR ILNICA
2432	FLORANT BRAMI	ARTUR ILIR FERRA		SOKRAT SEMINI	VIKTOR HOXHAJ	10 HAJRI ALLA
6936	SHERILJANA SEITAJ	BEDRI BRAKA		SOKRAT MUSTAFARAJ	REDI CUKO	11 ALI LALA
7576	ZAMBAK TOSKA	JONUS ZYKA		FLORIAN MISIRAJ	DASHNOR XHEMAJ	12 "BEHAR" RUSTEM
3353	ASTRIT HOXHA	PROLETAR MENKA		BUJAR BICAKU	BANUSH DUKA	"KOLAVER" KOLAVERI
256	FAIK FILAJ	KRISTAQ LUSHI		AGRON AJDINAJ	TAHIR BERISHA	13 SHYQYRI DERVISHI
6648	ILJAS CIMIS	SOTIRAQ PROFKA		SUELA VRAPI	JANI KOLA	14 NEZIR LUSHI
4419	NIKOLA ÇINA	LEDJON RUKO		QAMIL ISUFAJ	SOTIRAQ MITRAJ	15 SHEFTI REXHMATAJ



16 ALEKSANDER KOLA	94 SHEFQET DURRSI	167 MET/BESNIK/VESELCOKA/ COKA/COKA	243 UKE UKA	316 ALI BRUCI
17 HAVE BEGU	95 LLAN NEZHA	168 BAFTJAR NDREKA	244 LIMAN NIKOLLI	317 SELIM CERPIJA
18 TONIN GJONPJETRI	96 ASLLAN COKA	169 ASLLAN HIDAJ	245 ARTAN KALLARI	318 ALFRED DAFKU
19 FATIME UKA	97 AGOSTIN GJERGJI	170 PERPARIM/ASLLAN LUSHA/ LUSHA	246 ASTRIT/JUSUF TUFA/ TUFA	319 RUSHAN BREGASI
20 YLBER REXHA	98 FLAMUR LAME	171 HALIL GJOSHI	247 QAMIL/FATMIR AHMATI/ AHMATI	320 MANUSHAGE SEFA
21 "EQEREM"XHEVAT" DOMI	99 MEHDI HALILI	172 HALIL GJOSHI	248 ERIDION PLAKU	321 SADIK QOKU
22 "BAJRAM"ALBERT" ISUFI	100 LEON DEDA	173 ARMAND KUQI	249 AHMET BEGU	322 ALBERT HIDRI
23 FERTI VRAPI	101 LUTFI TAKA	174 ASTRIT/DONART GJONAJ/GJONAJ	250 HAJRIE MENA	323 BURHAN HYSA
24 ISLAM MENA	102 BESNIK SHPENDE	175 BASHKIM BALLIU	251 XHEVAT RUSI	324 YLLI ALLJAJ
25 FATMIR ALLUSHI	103 XHEMIL DACI	176 HAQIF GJASHI	252 ARTUR/DAVE SIRIXHI/ SIRIXHI	325 HUZRI HYSA
26 "RIZA" DASHNOR" BARDHOCI	104 "VESEL" FATIME" BUCI	177 ZEMI GJICI	253 MIRBAN LIKA	326 ILIR DALIPI
27 ILIR PACI	105 NAIM DAUTI	178 SMAJL SELIMAJ	254 ADEM HIDRI	327 FATOS SARACI
28 DRITAN KABASHI	106 LUMNON SPAHIU	179 PRENE GJONAJ	255 MARJETA BAJRAMI	328 ASTRIT DAFKU
29 XHELADIN CANI	107 BUKURJE TROCI	180 ZYHRA DUSHKU	256 ROLAND TERSHALLA	329 ILIR DOCI
30 JETMIR PRENGA	108 BERHAN PEPOSHI	181 XHEVAHIR PASHA	257 SHKURTE DIBRA	330 AGRON HAXHIU
31 RUSHIT GJAPI	109 HEKURANILNICA	182 HASAN SHAHINI	258 ENVER KALAVERI	331 BESJAN DOCI
32 SABA KAMERI	110 ALI DAJCI	183 SUL RATA	259 LULZIM/SELIM QEMA/ QEMA	332 AUREL GJONI
33 BAFTJAR NEZHA	111 ESAT DELLIU	184 DEDE LORI	260 SATBERE LEKA	333 EDMOND XHEPULLARI
34 ISAT KASEMI	112 ZEK QARRI	185 ILIR AJAZI	261 MAJLINDA/AGIM IMERAJ/ IMERAJ	334 NAIM KRASNIGI
35 MIMOZA MRISHAJ	113 HALIT AJAZI	186 INDRIT GJIKOLA	262 BESMIR MULGECI	335 GEZIM LALA
36 HAKI RAMAJ	114 OSMAN XHAJA	187 HAMDI PERGJEGJA	263 MARK HYSAJ	336 BARDHYLSINANI
37 MEDAT TORBA	115 ISMAIL Tafa	188 ISNI GJANA	264 ELEZ MURATI	337 FLUTURIM KORDHOKU
38 ALFRED HYSA	116 RUSHIT ZEKA	189 MEHDI MATMUJA	265 DYLEMANBUSHI	338 FIQIRI CANI
39 ABDULLA HODA	117 ADEM BITRI	190 SUADA CANI	266 SHPETIM SUCI	339 BARIQ HADRI
40 NAZMLJE TOKA	118 "ALVIN"BLERIM" MEZIU	191 LAVDERIM KOCI	267 HALIL LEKA	340 RUFAT/BILBIL BARA/ BARA
41 SHKELZEN BYBERI	119 ARBEN TOTA	192 MALIK PEPOSHI	268 LAVDRIM NOKA	341 PERPARIM ISLAMAJ
42 HASHMET ISLAMAJ	120 "DASHAMIR"YLLI" MERKOHASANI	193 YLLI MILLOSHI	269 DURIM ISEHITI	342 HASAN TOTA
43 XHEVAHIR HOXHA	121 "ZEF"KOL" GJETA	194 ARDJAN SKACAJ	270 GRAMOZ DOMI	343 DURIM NELA
44 BAJRAM DOCAJ	122 YTBLJE PYSQYLI	195 FLORIM SPAHIU	271 BEDRI MOLLA	344 ZAHIDE LUSHA
45 YLLI RAJKU	123 XHEVURJEKAZIU	196 ISAK BILLA	272 DERJAN ISLAMAJ	345 HAXHI GJIDIA
46 LIKE META	124 SETKLEJE DOMI	197 ELTON TOTA	273 LAZE MENA	346 YLBER SINAJ
47 ERMIR KARAJ	125 "SEJDIR" SADIJE" KURTI	198 LIRI XHELESHI	274 QATIP RAMA	347 KASTRIOT KINGJI
48 HAMZA SIFA	126 ROLAND HOXHA	199 ERMAL NIKA	275 XHAVIT MATMUJA	348 SEAT SKENDERI
49 "DEMIR"URIM"	127 FESTIM REXHMATI	200 NEXHMI HIDA	276 SADIJE/ARIF/FISNIK PLAKU/PLAKU/PLAKU	349 SHAQIR SUFA
"REXHMATAJ"REXHMATAJ"	128 FATMIR/SHPETIM KOVACI/KOVACI	201 FATMIR MUHADRI	277 HAJRI GEGA	350 PETRIT SUFA
50 SAIMIR DISHA	129 CANE MUJA	202 NDRICIM/IDRIS HOXHA/ HOXHA	278 RAM SELIMAJ	351 XHIL PERGJEGJI
51 GENTI BALLIU	130 ARTUR/LUME POKA/ POKA	203 NESIM PALUSHI	279 ARBEN MUZHAQI	352 OSMAN MISKU
52 CEN SELIMAJ	131 RONALD ILNICA	204 FASLLI IBRAHIMLLARI	280 PASHK UKA	353 ILIR PELLUMBI
53 HAXHI BEGU	132 ERVIS/ALEKS DOBRA/DOBRA	205 BEKIM CANI	281 FTIM MUCA	354 LAVDIE BUCI
54 XHEVAHIR KOCA	133 TOMORR YMERRI	206 SELAJDIN BREGASI	282 VILI LECI	355 BEQIR MURATAJ
55 ASLLAN LUSHI	134 ALEKSANDER LALA	207 ARDIANA HYSOLLARI	283 FATIME MOLLA	356 DIN BRATI
56 "NDOC"AGRON" RRUCAJ	135 VALDET LIKA	208 NAZZLE SEFA	284 FATJON HYSA	357 ASTRIT MIJA
57 TOFIK RUSI	136 HISMET ZELAJ	209 CEN HODA	285 HALIL SHQUTI	358 MOJSI LOSHA
58 BAJRAM BRUCI	137 GURI KUKELI	210 FATMIR/EDUART PJETRI/ PJETRI	286 ARTAN HYSENI	359 REXHEP VATA
59 "HYLMI"MEHXHIDE" DISHA	138 NEKI KALESHE	211 FRAN GJONI	287 HALIL ISLAMAJ	360 DRITAN DEDUKAJ
60 SABRI CUPANI	139 FLAMUR MORINA	212 SELIM SINANAJ	288 KLEMENDMEMA	361 MURAT MENKSHI
61 DED KECANI	140 MASLIME UKA	213 URIM SINANAJ	289 AGIM KETA	362 SHPETIM FARRUKU
62 MUSTAFA Tafa	141 OSMAN SELIMAJ	214 LIMAN HOXHA	290 FREDI VELLASI	363 SALI VANI
63 LEONIDHA HIDA	142 YLLI KOLA	215 SELMAN VLADI	291 XHEMAL NUZI	364 IBRAHIM SKENDERI
64 DRITAN PRELA	143 FATMIRA MANI	216 LATIF ASLLANAJ	292 LUTFI TAHIRI	365 FLUTURIM MORINA
65 BARDHYL LUSHA	144 DHURATA HOXHA	217 FARI HOXHA	293 BEDRI LITA	366 SAFET NUZA
66 LEONARD MAKLEKAJ	145 ETHEM DAKU	218 GEZIM FISHTI	294 GEZIM XHEDIKU	367 BASHKIM/SKENDER HAXHIU/ HAXHIU
67 FATMIRE SELIMI	146 SEFULLA/URIM XHOKA/GJOKA	219 HILMI TROCI	295 REXHEP KADRIU	368 SHKELQIM/SELIM THACI/ THACI
68 BESIM PRENGZAJ	147 ALUSH SELIMAJ	220 SELMAN CAHANI	296 VLADIMIR SHABANAJ	369 HYSEN/ERBEN IS- LAMAJ/ISLAMAJ
69 RASIM BUCI	148 GJYLJANA KOTORRI	221 ILIRJAN DEMIRAJ	297 ILJAZ/ISMEN HIMAL- LARI/HIMALLARI	370 ADMIR ISLAMAJ
70 "REXHEP"SHKELZEN"XHEVAT	149 SHEFQET VLADI	222 BASHKIM KASEMI	298 NURI ELQENI	371 EDISON PILLATI
"HAMZA"BAJRAM" KOLAVERI	150 DASHAMIR MILLA	223 QERIM KAZIU	299 ZAIM VLADI	372 HAXHI CERPIJA
71 "ASTRIT"AFRIM" FERATI	151 ALI/EDUART/KASTRIOT BALLA/BALLA/BALLA	224 QERIM CENMURATI	300 RAMADAN KOVACI	373 FETA NURCJA
72 INDRIT TAHIRAJ	152 ZENEL/RAHMAN PEPOSHI/ PEPOSHI	225 AJET BUSHI	301 RAMZAN MIPTARAJ	374 OSMAN ARUCI
73 ARBEN CAHANI	153 BINAS SULKU	226 FETIJE PARTALLI	302 ALTIN/FERIK LACI/ LACI	375 YMER LIMANI
74 XHAFERR NECI	154 KUJTIM/VJOLLCA KOXHA/ KOXHA	227 SELMAN/MANUSHAGE CAJKA/CAJKA	303 AGUSTIN LOPARI	376 SULEJMAN LEKA
75 ZABIT GJABRI	155 SAMI DACI	228 SELVIE ADEMAJ	304 KEVIN LITA	377 MUSLI OSMANI
76 RUZHIDIDERVISHI	156 LUFTAR/JETMIR/ALI/ MENTOR/ARBEN DEDA/DEDA/DEDA/ DEDA/DEDA	229 ISMAIL DOKU	305 DRITA LACI	378 AGIM BUCI
77 AGIM TUFA	157 NAZMI/HAVE CERPIJA/ CERPIJA	230 ZENEL SAVA	306 FATLI MECOLLARI	379 ENVER VATA
78 XHEVAHIR MYRTJA	158 SAMET QOKU	231 BEKHET POKA	307 ALI TOLA	380 RRAHMAN/LUAN KOLA- VERI/KOLAVERI
79 BYLBYL DEGA	159 BESNIK GJINOLLARI	232 PASHKE GJONI	308 VALENTINMARPEPA	381 BAZ ZELA
80 FERTI BUCI	160 LAVDIE/KUJTIM HALLI/ HALILI	233 AJAZ PERZHILLA	309 NEXHMI HOXHA	382 GJYSLIME HASALAMI
81 SHAQIRDODA	161 ESAT/HAJRI BUCI/BUCI	234 LIRIJE CERPIJA	310 EDUART MARPEPA	383 MIPTAR CANI
82 QAMIL CALA	162 AVNI TROCI	235 BESNIK DOCI	311 XHETAN SULA	384 ARTAN ALLUSHI
83 ERMIR TAPA	163 NASUF XHEPA	236 TAHR MORINA	312 NAFERIE KACI	385 AGRON NIKOLLI
84 AVDI CAHANI	164 KUJTIM DEDA	237 SADIK MURATI	313 ILIR GJIKOLA	386 GEZIM MYFTARI
85 ARBEN METANI	165 ASTRIT SEFOLLI	238 NEIP HOXHA	314 ISMAIL MARKU	387 GEZIM PRENGA
86 NAIM BARDHI	166 NESHAT HOXHA	239 BAFTJAR QERIMI	315 RESHAT RRAPI	388 ALI BAJRAMAJ
87 LEZAN DODA		240 KADRI SPAHIU		389 PAJTIM KALOSHI
88 "HAZIS"SUILLTANE" "DEDA"DEDA"		241 EMIN BALA		390 GZIM FERATI
89 XHELAL GJORGJI		242 IDAJET MARKU		391 ASLLAN DOMI
90 QAMIL FARRICI				
91 BASHKIM MURATI				
92 "SERVETE"IZET" BARDHYL"ALI" MURATI				
93 ERMAL MEMAJ				





PËRSE JEMI TË PËRGJUMUR KUR BIE SHI?

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E mërkurë 1 Gusht 2018



**Oriola Marashi, një "bishë" seksi**



**Elvana, më e freskët se kurrë**

**BULEVARDI POLITIK**



- I "largohet" vapës së korrikut, Presidenti Meta shkon në Vermosh
- Ish-ministri Saimir Tahiri, në homazhet për Luan Hajdaragën shfaqet me 'look' të ri
- Erion Veliaj: Do rikandidoj sërish për kryeqytetin
- U nderua me Urdhrin Kombëtar të Francës, Mimi Kodheli ia dedikon mamasë 80 vjeç



Rrëfëhet tenori: Eksperiencat gjatë debutimeve ndërkombëtare dhe vlerësimet

## **SOLEN ALLA:** Ja interpretimi im në krah të Inva Mulës

*"Tirana është pikë frymëzimi për mua"*

Grëfhet tenori: Eksperiencat gjatë debutimeve ndërkombëtare dhe vlerësimet


# Solen Alla:

## Ja interpretimi im në krah të Inva Mulës

*"Tirana është pikë frymëzimi për mua"*

Egla Xhemali

Solen Alla (bariton) ka lindur në Tiranë në qershor të vitit 1988. Ka nisur studimet për muzikë që në moshë të re pranë liceut artistik "Jordan Misja" për instrument frymë (flaut). Më pas vazhdon studimet në "Universitetin e Lartë të Arteve" në degën e kantos. Që në vitet e studimit është angazhuar me koncerte edhe shfaqje pranë Teatrit të Operas dhe Baletit. Gjithashtu, merr pjesë në disa "Master Class" të zhvilluara me pedagogë nga më të njohurit si brenda edhe jashtë vendit, si me pedagogen Tamara Rachum (Izrael), Vitto Brunetti (Itali), Carmen Gonzales (Spanjë), Danusa Luknisova (Sllovaki, me mezo soprano) e famshme Bruna Baglioni (Itali), me Giancarlo Checharini edhe Alberto Paloscia në (Itali). Ka bërë edhe një master mbi artin skenik me regjisorin Sergio Costanzo Licursi. Numërohen disa role në operat e ndryshme të kënduara në TKOB Si Fleville në operën (Andrea Chenier) të U.Giordano Johan në operën (Werther) të J.Massenet në krah të tenorit të famshëm shqiptar, Saimir Pirgu Hermann, në operën "Les contes d'Hoffmann" të J.Offenbach në krah të sopranos Inva Mula. Më pas në operat e repertorit Nazzional si (Borana) e Avni Mulës, ku këndon personazhin protagonist të Marka Suiës, për të vazhduar me një protagonist tjetër tek opera "Lulja e Kujtimit" e Kristo Konos, ku këndon personazhin e Kristos. Jo më pak të rëndësishëm ishin rolet tek opera "Skënderbeu" e Prengë Jakovës, ku këndon personazhet e Plakut të ver-



Opera "SKËNDERBEU"  
Kompozitor Prenk Jakova  
Plaku i verbër - Solen Alla



Opera "L'ELISIR D'AMORE"  
Kompozitor Gaetano Donizetti  
Belcore - Solen Alla

bër edhe Pal Dukagjinit në të njëjtën nafë në Teatrin e Operas së Shkupit. I vlerësuar me çmimet "Ramiz Kovaci" edhe çmimin e parë në konkursin "Jorgjie Truja". Më pas në skenat ndërkombëtare do ishin opera "Le Convenienze ed inconvenienze teatrali" të Gaetano Donizetti, ku është kënduar në disa teatro të Italisë si teatri "Giuseppe Verdi" të Pisa Teatro Carlo Goldoni të Livornos. Po ashtu

rolli i Tonios në operën "Pagliacci" të Ruggero Leoncavallo pranë tenorit me famë botërore, Marcello Giordano edhe nën regjinë e të mirënjohurit Lino Privitera. Ka qenë pjesë marrëse në koncerte të ndryshme jashtë vendit si në Israel, Greqi, Mal të Zi, Maqedoni, Itali, Francë. Në Paris ka qenë shpeshherë i ftuar me maestro Zhani Cikon për të kënduar disa nga veprat e kompozitorit iranian Mohammad Shahms. Në Shqipëri edhe Kosovë me recitale, i shoqëruar nga koncert maestraja e TKOB, Ingrid Pulizo.

Një tenor i ri në moshë që na rrëfen për suplementin "Summer Pages" të fshehtat e botës së artit, eksperiencat e jashtëzakonshme që e bënë më të lehtë debutimin ndërkombëtar, ambicjet si dhe për jetën personale. Soleni e ndan jetën mes Shqipërisë dhe Italisë. Ai pohon se ka lidhje mjaft të forta me Tiranën dhe se i mungon familja. Rrethi artistik në Itali e ka pikasur talentin e tij dhe prej tyre ka marrë vlerësim maksimal. Një nga ambicjet më të mëdha të tenorit është që të debutojë kudo nëpër botë. Frymëzimi i tij është natyra, ku dhe ndjen se si tingujt ndërthuren magjishëm dhe e bëjnë të rigjejë veten. Për të, një nga interpretimet më të dashura ka qenë ai me Inva Mulën, pa harruar dhe bashkëpunime të tjera me artistë të tjerë. I pyetur për jetën private, Soleni i buzëqeshur pohon se është beqar dhe se dashuria e

tij më e madhe është mbesa, Amelia.

**Ju jetoni aktualisht në Itali, si u infiltruat në botën e artit atje?**

Për momentin jetoj midis Shqipërisë dhe Italisë, infiltrimi ose prezantimi me botën e operës në Itali ka lindur që në vitet e mia të studimit, kur u organizua një shfaqje opere e kompozitorit italian Pietro Mascagni dhe m'u besua një rol protagonist në operën "Silvano". Aty kam bashkëpunuar me regjisorin e mirënjohur italian Alberto Paloscia, i cili më vonë më ftoi të ndiqja një specializim opera studio, që konkludonte me një shfaqje që do të më bente të debutoja në disa teatro të krahinës së Toskanës në Itali.

**Kishte paragjykime nga artistët përreth, sepse një shqiptar i ka zënë vendin?**

Paragjykime nuk do të thosha, pasi vajta ime atje vinte pas shumë këngëtarësh, të cilët tashmë bëjnë një karrierë mëse dinjitoze ndërkombëtare, ndaj në një farë mënyre emri i mirë i tyre ka lënë tashmë një përshtypje shumë të mirë në rrethin artistik këtu. Sapo dëgjohet që kam ardhur nga Shqipëria, direkt shoqërohet me frazën e tyre "Shqiptarët kanë zëra të bukur".

**Si është jeta juaj në Itali?**

Jeta ime është si e çdo këngëtarë të ri, i cili kërkon të bëjë karrierë. E shoqëruar me pjesëmarrje në konkurse e audicione të ndryshme, por shumë

interesante edhe frytëdhënëse kanë qenë edhe "Master class"-et e ndryshme që kam frekuentuar këtu. Tek to kam pasur fatin të marr mësim nga këngëtarë, regjisorë dhe dirigjentë shumë të njohur, të cilët kanë qenë një eksperiencë shumë e vyer profesionale për mua.

**Çfarë ju mungon më shumë andej?**

Sigurisht gjëja kryesore që më mungon është familja ime, pra prindërit e mi. Por, edhe Tirana, qyteti im me të cilin jam i lidhur shumë. Kudo shkoj mbaj me vete diçka që ka lidhje me të edhe me këdo njihem ose takoj këtej, flas për Tiranën, për traditat e saj, zakonet, kostumet tradicionale, këngët popullore dhe historitë e tyre. Është pak a shumë një pikë frymëzimi për mua.

**Cilat janë ambicjet e tua profesionale?**

Ambicjet janë të shumta. Sigurisht, që të kem një karrierë më të qëndrueshme këtu dhe të arrij të këndoj në teatrot e mëdha repertorin tim, të cilin i përshtaten edhe rolet e ndryshme në operat më të njohura, të cilat mund t'i debutoj në vende të ndryshme të botës. Kjo normalisht është ëndrra e çdo këngëtarë lirrik.

**Cila është muza jote?**

Muza ime është e pranishme në çdo moment të jetës. Me frymëzimin shumë natyral dhe në përgjithësi ambientet e gjelberuara. Në të gjenden tinguj të jashtëzakonshëm, të cilët në fakt qenë ata, të cilët sollën në jetë muzikën, artin me të cilin merrem. Frymëzimi ose muza vjen kudo ka tinguj të bukur për mua.

**Cilët janë ato artistë që ti do të arrish, a keni lidhje me shqiptarë të famshëm nëpër botë brenda artit sigurisht?**

Të them të drejtën nuk mendoj asnjë emër, të cilin mund të them se do të doja të arrija, pasi mendoj se çdo artist duhet të përsosë veten edhe të gdhëndë emrin e tij në botën e artit. Askush nuk mund të jetë si një tjetër edhe askush nuk mund të bëhet si një tjetër. Me artistët shqiptarë të njohur në botë kam pasur fatin të interpretoj në krah të tyre si për shembull me tenorin Saimir Pirgu ose sopranon Inva Mula. Gjithashtu, kam pasur fatin të marr edhe mësim nga tenori ynë i madh Josif Gjipali. Sigurisht, që kemi marrëdhënie të mira si me këdo që kam bashkëpunuar, ose kam marrë mësim prej tij.

**Çfarë bën Solen me jetën personale?**

Me jetën personale nuk bëj ndonjë gjë të veçantë nga çdo moshatar i imi.(qesh) Për momentin jam beqar, pasi duhet të rend për jetën time profesionale. Kam vetëm një dashuri për momentin edhe ajo është mbesa ime e vogël, Amelia.







## E lagur brenda një vaske, Olta Gixhari nuk di të ndalet

Aktorja e njohur Olta Gixhari duket se nuk do ndalet këtë verë me postimet provokuese. Ajo ka publikuar një foto në rrjetin social "Instagram", në të cilën duket aq tunduese, sa askush nuk do dëshironte të mos e shihte. E veshur me një fustan të zi dhe brenda një vaske me ujë, Olta duket sikur ka gjetur "shpëtimin" për temperaturat përvëluese të këtyre ditëve të nxehta. Ndërkohë, kjo foto nuk mund të mos shoqërohej me reagime komplimentuese të fansave të aktore.



## Vajza e Majlinda Bregut nxjerr sheshit të pasmet

Vajza e ish-deputetes demokrate Majlinda Bregu ka zgjedhur Sicilinë për të pushuar. Kejda Ajazi është një tundim i gjallë me postimet e saj më të fundit në rrjetet sociale. Bukuroshja ka vendosur të "djegë" përsëri "Instagram"-in pas fotos ku ekspozoi gjoks. Këtë herë bukuroshja duket tejet në formë me pantallonat ekstremisht të shkurtra, të cilat i kanë lejuar të pasmet e saj të ekspozohen mjaftueshëm. Jo të pakta kanë qenë reagimet pozitive të gjithë ndjekësve të saj për fotot e Kejdes.



## Elvana, më e freskët se kurrë

Këngëtarja Elvana Gjata ka publikuar në rrjetet sociale një foto mjaft të ëmbël, në të cilën shfaqet tërësisht "ujë dhe sapun". Pa tualet, e buzëqeshur dhe me kapele bukuroshja duket mjaft në formë dhe e relaksuar. Gjatë kësaj periudhe ajo ka pushuar në vende të ndryshme të botës. Vetëm pak javë më parë Elvana publikoi bashkëpunimin e suksesshëm me reperin Ledri Vula dhe këngëtarin John Shahu nën titullin "Mike", që u bë hit dhe u pëlqye shumë nga fansat e këngëtarëve.



## Oriola Marashi, një "bishë" seksi

Nuk mund të ndodhë që modelja Oriola Marashi të publikojë diçka në rrjetet sociale pa tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Bukuroshja ka qenë mjaft aktive me postimet e saj. Këtë herë ajo ka publikuar në "Snap Chat" një video me një prej opsioneve më të pëlqyera në të. Teksa shfaqet super e lumtur, në një prej momenteve të videos anëtarja e OTR duket sikur do të "kafshojë" veten.







**S**hkakun kryesor përse zgjimi në mëngjesin me shi është më i vështirë se zakonisht, apo përse në ditët me shi ka më shumë gjumë dhe ndryshime hormonale e tregon studimi i Universitetit Shtetëror në Pensilvani. Nëse dita është me shi, ka më pak dritë, prandaj trupi sekretion më pak serotoninë, ndërsa melatoninë më shumë, hormone të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për humorin dhe vigjilencën tuaj. Shumë njerëz në ditë me shi ndihen të përgjumur, por a ka ndonjë shpjegim shkencor lidhur me këtë, pasi është një fenomen shumë i përhapur tek shumë njerëz?

**NUK FLINI SIÇ DUHET**

Një studim i kryer nga laboratoritë e gjumit në Universitetin Rochester ka treguar se në netët me shi njerëzit nuk flenë shumë. Prandaj, në netët me shi ju nuk flini shumë dhe kur zgjoheni, nëse ende ka shi, do të ndiheni të përgjumur dhe të lodhur.

**SHUMË MELATONINË**

Melatonina është hormoni që ndihmon që trupi të rregullojë qarkun e gjumit dhe të zgjimit. Sa më shumë ta prodhojë trupi këtë hormon, aq më të lodhur do të ndiheni. Por melatonina gjithashtu ndihmon që trupi juaj të eliminojë dritën dhe kështu që ju mund të flinin natën, ndërsa në mëngjes kur del dielli, trupi fillon që të prodhojë melatoninë në mënyrë që ju të zgjoheni. E kur ka shumë re dhe ka shi, prodhimi i melatoninës është i lartë, prandaj ju nuk mund të flini.

**SEROTONINË E**

**PAMJAFTUESHME**

Ashtu sikurse qielli me re i shkakton trupit tuaj prodhim të tepruar të melatoninës, po ashtu në trurin tuaj nuk prodhohet sasi e mjaftueshme e serotoninës. Serotonina është një neurotransmetues që është i lidhur me lumturinë. Kur hani ushqim ju prodhoni serotoninë, por rrezet e diellit në prodhimin e këtij hormoni kanë një rol të madh. Prandaj, kur ka më pak diell, truri prodhon më pak serotoninë, gjë e cila çon në që të

# Përse jemi të përgjumur kur bie shi?



ndjeheni i depresionuar dhe të keni mungesë të motivimit. Për këtë arsye jeni pak dembelë, pak të përgjumur në

ditët me shi.

**TINGUJT QETËSUES**

Zhurma kur pikat e shiut bien në dysheme, dritare apo çati

krijon një lloj tingulli. Ky tingull mund të jetë ritmik dhe nëse është i tillë, ky tingull hynë në trurin tuaj dhe

shndërrohet në një ninullë qetësuese gjatë gjithë ditës. E efekti i kësaj zhurme mund të ju sjell më shumë gjumë.



## "I largohet" vapës së korrikut, Presidenti Metashkon në Vermosh

Me mbylljen e sesionit parlamentar, politikanët kanë "lënë" paksa mënjane langazhimet e tyre, për të pushuar. Po kështu, edhe kreu i shtetit, Ilir Meta, pas vendimit për mosdekretimin e ligjit për teatrin, duke e kthyer sërish në Kuvend, ka lënë ambientet e zyrës duke zgjedhur të jetë mes natyrës. Ndryshe nga vera e kaluar, ku u fotografua duke pushuar në plazhet e Dhërmiut, këtë verë presidenti duket se ka zgjedhur t'i largohet vapës së korrikut. Përmes disa fotove të publikuara në profilin zyrtar të tij në rrjetin social "Facebook", Presidenti Meta na tregon se ndodhet mes mrekullive të alpeve shqiptare. "Një udhëtim mbresëlënës në Leqet e Hotit, në Selcë-Cem, në Lëpushë e Vermosh, mes mrekullive të alpeve shqiptare, aty ku turistët i gëzohen rrugës së re dhe turizmit malor", shkruan Presidenti Meta.



## Ish-ministri Saimir Tahiri, në homazhet për Luan Hajdaragën shfaqet me 'look' të ri

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri që nga koha kur hoqi dorë nga mandati i deputetit, ka zgjedhur që të shfaqet shumë rrallë në publik. Ndërkohë dje, është fotografuar në homazhet që po mbahen në Kuvend në nder të ish-ministrit të Mbrojtjes, Luan Hajdaraga. Tahiri shfaqet me një 'look' krejt ndryshe, i veshur sport, me xhinse, t-shirt dhe me mjekër, ndërsa qëndron pranë ish-kolegut Pirro Lutaj. Pas shpinës së dy socialistëve shfaqet edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, i cili është duke u larguar.



# BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

## POLITIK



## Erion Veliaj: Do rikandidoj sërish për kryeqytetin

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj ka treguar planet e ardhshme në politikë, si dhe raportin me Edi Ramën. Ai e pohon në mënyrë të prerë se do të jetë kandidat për një mandat të dytë për të drejtuar kryeqytetin shqiptar. "Për vitin tjetër patjetër, edhe unë do t'i nënshtrohem një gjykimi të Partisë Socialiste. Unë kandidoj me atë uniformë, me atë bluzë. Dëshira është për të çuar punët përpara", tha Erion Veliaj, i ftuar në emisionin "Pushime on Top". Por cili është raportin me kryeministrin Edi Rama dhe a ka marrë bekimin e tij për të gjitha punët e bëra kryetari i bashkisë? "Unë jam me shumë fat. Unë nuk e di si është të punosh me një kryeministër që nuk të mbështet, sepse unë i kam parë vetëm një anë të shkëlqyer të një kryetari bashkie që mbështetet nga kryeministri i vet, por për fat edhe ai ka qenë kryetar bashkie. Nëse dikujt duhet t'ia shpjegoj shiko se ky kanalizimi aty... se kjo rruga na e ndan lagjen, ai klikon menjëherë. Unë kam qenë shumë i bekuar", tha Veliaj.



## Underua me Urdhrin Kombëtar të Francës, Mimi Kodheli ia dedikon mamasë 80 vjeçe

Një ditë më parë Mimi Kodheli u dekorua nga Presidenti i Francës, Emanuel Macron me Urdhrin Kombëtar të Legjionit të Nderit. Një nga titujt më të lartë dhe të rëndësishëm që jep presidenti francez. Urdhri prestigjioz iu dorëzua nga ambasadorja e Francës në Shqipëri, ndërsa sot ish-ministria e Mbrojtjes ka gjetur rastin që të falënderojë Presidentin e Francës dhe të gjithë ata që bënë të mundur këtë vlerësim. "Falënderoj Presidentin E. MACRON që më nderoi me titullin e lartë të Republikës së Francës, 'Kalorës i Urdhrit Kombëtar të Legjionit të Nderit'. U jam mirënjohëse të gjithë atyre që bënë të mundur marrjen e këtij titulli. Faleminderit kujtdo që ka kontribuar sado pak në bërjen të mundur të këtij nderimi", shkruan Kodheli në faqen e saj në "Facebook". Por ky titull ka ardhur në një moment të veçantë për Kodhelin, pasi nëna e saj ka mbushur plot 80 vjeçe. Ndaj ajo ia ka dedikuar pikërisht asaj marrjen e këtij titulli. "Këtë titull ia dedikoj mamasë sime në 80-vjetorin e saj!", shkruan Kodheli.



KAMPIONATI KOMBËTAR

# Minifutbolli

## Shqipëria, gati për Kampionatin European

"Prestige", birra "Korça" e uji "Fab", sponsorë të Kombëtares

Nisi si një ide për të bërë bashkë futbollistët joprofesionalistë nën një sigël, në një shoqatë të futbollit amator, por shumë shpejt ky projekt nisi të zbatohet dhe brenda një viti organizuan për herë të parë një kampionat kombëtar. Shoqata e Futbollit Amator, tashmë anëtarë me të drejta të barabarta në Federatën Europiane të Minifutbollit do të marrë pjesë për herë të parë në një Kampionat European, i cili do të zhvillohet në Ukrainë nga data 12 deri më 18 gusht. Futbollistët më të mirë që prodhoi kampionati kombëtar do të përfaqësojnë Shqipërinë në këtë turne prestigjioz, ku kuqezinjët bëjnë pjesë në grupin C së bashku me Bosnjë Hercegovinën, Bullgarinë, Irlandën dhe Kazakistanin. "Falë ekipeve që morën pjesë në kampionatin e parë, që i besuan këtij projekti, pasi pa ata nuk bënim dot; falë mbështetjes që kemi pasur nga sponsorët, ku sponsori gjeneral është birra 'Korça', hotel 'Prestige', uji 'Fab', që kanë mbuluar kostot e pjesëmarrjes në këtë aktivitet. Sponsori ynë teknik që është Federata Shqiptare e Futbollit si dhe kompanisë që na mundësoi udhëtimin në Ukrainë u bë e mundur që të kristalizohej ajo që e kishim ëndërruar. Shkojmë që të përfaqësojmë Shqipërinë jo vetëm si turistë, por edhe me pretendime", tha Ervin Bytyçi, kryetar i Shoqatës së Minifutbollit Amator. Prej tri javësh ekipi përfaqësues i minifutbollit vijon fazën përgatitore me intensitet të plotë dhe trajneri Andi Koçi shprehet i kënaqur me punën e bërë. "Mendoj se kemi bërë një punë të mirë deri tani. Është një eveniment shumë i rëndësishëm dhe është viti i parë që marrim pjesë në të tillë event. Shpresojmë që të arrijmë diçka pozitive", tha Koçi.

Fatmir Hysenbelliu ishte protagonist kryesor i kampionatit të parë Kombëtar të Minifutbollit. Kapiteni i "Prestige" mbylli një sezon perfekt duke



Në foto: Kapiteni i skuadrës "Prestige" z.Fatmir Hysenbelliu në dorëzimin e trofeut nga kryetari i Shoqatës së Minifutbollit Amator, z.Ervin Bytyçi



Në foto: Skuadra fituese "Prestige"



Në foto: Kapiteni i skuadrës "Prestige" z.Fatmir Hysenbelliu

"Qëllimi ynë nuk është thjesht të marrim pjesë dhe të shkojmë për pushime, por të shkojmë atje denjësisht dhe të synojmë vendet e para. Synoj mbas të dal edhe atje golashënues. Ky është një test për ne, sepse është viti i parë që organizohet ky lloj turne. Normalisht që për mua është përgjegjësi e madhe, por kjo më bën edhe më krenar e të eci fort dhe të kem një performancë sa më të mirë dhe ndeshje pas ndeshjeje të rritem sa më shumë", tha Hysenbelliu.



Në foto: Kapiteni i skuadrës "Prestige" z.Fatmir Hysenbelliu në ndeshje

u shpallur kampion me ekipin e tij dhe duke fituar titullin e golashënuesit më të mirë, me 22 gola në dhjetë ndeshje. Fatmiri pritet të udhëheqë ekipin Kombëtar si kapiten edhe në European, një përgjegjësi e madhe për të dhënë më të mirën në këtë turne. "Qëllimi ynë nuk është thjesht të marrim pjesë dhe të shkojmë për pushime, por të shkojmë atje denjësisht dhe të synojmë vendet e para. Synoj mbas të dal edhe atje golashënues. Ky është një test për ne, sepse është viti i parë që organizohet ky lloj turne. Normalisht që për mua është përgjegjësi e madhe, por kjo më bën edhe më krenar e të eci fort dhe të kem një performancë sa më të mirë dhe ndeshje pas ndeshjeje të rritem sa më shumë", tha Hysenbelliu.



Në foto: Trajneri i skuadrës "Prestige" z.Andi Koçi

Prej tri javësh ekipi përfaqësues i minifutbollit vijon fazën përgatitore me intensitet të plotë dhe trajneri Andi Koçi shprehet i kënaqur me punën e bërë. "Mendoj se kemi bërë një punë të mirë deri tani. Është një eveniment shumë i rëndësishëm dhe është viti i parë që marrim pjesë në të tillë event. Shpresojmë që të arrijmë diçka pozitive", tha Koçi.



Në foto: Ekipi përfaqësues i minifutbollit "Prestige"



DEBATI

# KOMISIONI EUROPIAN: “Teatri”, kemi kërkuar informacion nga autoritetet shqiptare

Fatmira Nikolli

**G**enoveva Ruiz Calavera, drejtoresha e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor në Komisionin e Zgjerimit i ka dërguar dje një letër Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit.

**“Të nderuar anëtarë!**

Ju falënderojmë për letrat tuaja të datave 12 dhe 15 korrik adresuar komisionerit Hahn sa i takon Ligjit Special lidhur me zhvillimin e një projekti që përfshin ndërtimin e një ndërtese të re për Teatrin Kombëtar në Shqipëri. Komisioneri më ka kërkuar t’u përgjigjem në emër të tij.

Për fat të keq, për shkak të axhendës së tij të ngarkuar, komisioneri nuk ishte në gjendje t’ju takonte gjatë vizitës së tij në Tiranë më herët gjatë këtij muaji. Gjithsesi, ne i kemi parë me interes të madh argumentet tuaja lidhur me vlefshmërinë e ligjit të mësipërm. Komisioni u ka kërkuar autoriteteve shqiptare të japin informacion shtesë në lidhje me Ligjin Special, në mënyrë që të vlerësojë pajtueshmërinë e tij me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociativ mes Bashkimit Europian dhe Shqipërisë e gjithashtu me rregullave të Bashkimit Europian në fushën e ligjit të konkurrencës dhe prokurimit publik.

Pas dorëzimit të informacionit shtesë, Komisioni mundet tani të procedojë me rishikimin e nevojshëm dhe të lidhet me autoritetet”, përfundon letra e Calaveras.

Bashkë me letrën e drejtoreshës për Zgjerimin, Aleanca thotë se zëri i artistëve dhe qytetarëve të Aleancës është dëgjuar edhe në Bruksel. “Insistimi i vazhdueshëm i të gjithëve ka vlejtur. Tashmë Komisioni po merr në shqyrtim Ligjin Special dhe problemet e tij dhe pritet një opinion prej tyre. Aty propaganda për ‘punë dhe jo llafë’ nuk vlen më”, shton AMT.

**PËRÇARJA**

Një prej drejtuesve të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, Kastriot Çipi, përmes një postimi në “Facebook”, thotë se edhe pas kthimit në Kuvend të projektligjit, që synon shembjen e TK e TKE ka artistë që thonë se nuk e kuptojnë ku është problemi, duke shtuar se nuk e dinë se çfarë ligji apo neni i Kushtetutës është shkelur. “Por edhe nëse është shkelur, shtojnë se nuk është puna e tyre të merren me shkeljet ligjore, por e gjykatave. Bëjnë sikur nuk e dinë se nuk kemi as Gjykatë Kushtetuese, as të Lartë, megjithëse disa prej tyre kanë madje anëtarë të familjes që janë juristë”, - nënvizon Çipi. Në vijim, ai pohon se, “ca thonë se kanë marrë besën e atij që gënjën ‘live’ në TV. Të tjerë thonë se nuk u intereson sa kulla bëhen dhe kush i bën. Dhe të gjithë riciklojnë plehun e propagandës se teatri i ri do të bëhet pa para publike (meqë bëjnë sikur nuk e dinë se trulli

*Letra e drejtoreshës së Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor: I kemi parë me interes të madh argumentet tuaja*

*Kastriot Çipi: Po, jemi të përcarë, njësoj si më 1990 një pjesë e jona sot është bërë një me diktaturën*



publik është para publike)”. Teksa vëren se (ata) përpiqen t’i mbushin mendjen vetes (se zor se bindin dot njeri tjetër) se firma e tyre mbron çdo centimetër katror (të trullit që nuk është i specifikuar në ligj, as me shifra e as me harta) të TK e TKE vë në dukje se madje këtë të fundit nuk e zënë në gojë kurrë, në asnjë dalje publike. “A thua se ai nuk ekziston fare. Pasi i thonë të gjitha këto, nuk dinë të thonë pse firmosën kërkesën e fundit për Presidentin, nëse janë vërtet kaq indiferentë? Natyrisht, askush prej tyre nuk do të ishte i interesuar të dinte, psh., sa spjunë të Sigurimit ka në grupin e tyre.

As se kush po merr projekte e licenca biznesi. Nuk u interesojnë më as fjalët që i kanë thënë njerëz tjetrit publikisht para ‘marrëveshjes historike’ me Lalin. E meqë ra fjala të “marrëveshja”, më vjen mirë që, të paktën këtë herë nuk po del njeri të thotë se ne që jemi kundër shembjes së TK e TKE i ‘premë në besë’ apo se ‘i kemi deleguar të nënshkruajnë letrën për presidentin’”, - ironizon ai.

Në fund ai pohon: “Po, jemi të përcarë. Njësoj si më 1990 një pjesë e jona sot është bërë një me diktaturën. Na akuzojnë se jemi të manipuluar nga opozita, por

pretendojnë se janë të pavarur nga pushteti. Dhe njësoj si atëherë, pasi ta fitojmë këtë luftë (që mbaron me restaurimin e plotë të TK e TKE) ne nuk do të kërkojmë persekutimin e tyre, as diskriminimin me vendet e punës apo financimin e projekteve”. Sipas tij, secili prej tyre, duhet të ruajë aq respekt për veten, sa të mos shkelë më, as në sallën, as në skenën e atij teatri, që e kanë quajtur “karakatinë”, “dopolavoro”, “që nuk i përfaqëson”, “teatër që nuk plotëson standardet”, “ndërtesë kancerogjene”, “vjetërsirë”, “fashiste”! Përndryshe do t’i meritojnë fishkëllimat e publikut.

**LETRA PËR PD**

Komisioni Europian i ka nisur një letër për çështjen e teatrit edhe Partisë Demokratike. Komisioneri për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit Komisioneres Vestager ku ngrihet shqetësimi për ligjin nr 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” (ligji special) thotë se Komisioni u ka kërkuar autoriteteve shqiptare të paraqesin informacion shtesë dhe se Komisioni do mund të procedojë me rishikimin e nevojshëm si dhe respektivisht do të angazhohet me autoritetet shqiptare për këtë çështje. Letra u drejtohet Genc Pollos, Albana Vokshit, Florion Mimës dhe Jorida Tabakut..

**47 DITE TEATRI**

## Sokol Angjeli: Mos bëni rolin e strucit



in a jeni për shembjen e Teatrit Kombëtar? Dhe pastaj a jeni për shembjen e Teatrit Eksperimental? Pasi t’u përgjigjen që jemi dakord për shembjen e dy teatrove, atëherë të flasë. Ai nuk e bën qëllimisht pyetjen e parë: A jeni dakord për shembjen? Ai qëllimisht pyet a doni teatër të ri se ata që janë larg nuk e kuptojnë mirë”, tha Angjeli mes merris dhe trishtimit. Për të,

edhe kolegët nuk janë pa faj. “Ata që duan që asnjë cm toke të mos i merret teatrove, duhet të kuptojnë që ka mashttrim. Gjurma e teatrove dhe e projektit nuk është e njëjtë. Kolegët që janë mashtruar nuk e kanë të qartë. Ata do llogarisin 3 katet për këtë hapësirë. Ata do na mashtrojnë por këtë mashttrim e kemi zbuluar që tani. Jo kolegët të dashur. Mos bëni ro-

lin e strucit që të fusni kokën në rërë”, tha Angjeli.

Ai shtoi se e denoncon këtë histori se siç thotë Aurel Plasari, dua ta kem faqen e bardhë nesër pasnesër. “Po t’i pyesësh kolegët a doni ta prishni teatrin, asnjë nuk do thotë po. Atëherë pse janë rreshtur kështu shokët tanë?”

Do mblidhemi katër institucione në një godinë të sajuar (Turbina). Katër vjehra në një shtëpi. Një zot e merr vesh se si do merremi vesh me njëri-tjetrin. Mbase në vitin e parë e të dytë do kemi kontrata 1-vjeçare. Më pas doni thotë që nuk u zë të gjithëve. Më pas do na thonë po patëm punë do u thërrasin. Ashtu si u shua Estrada e Shtetit, ashtu si po shuhet Cirku dhe ja kështu do shuhet Teatri Kombëtar. Ne do themi nuk u bëjnë ne, u bëjnë ata që të kenë faqen e zezë”, e mbylli ai fjalën.

Opinion i Ditës

# Gati një në çdo tre tendera e zhvillojmë duke biseduar!

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... dhe shëndetësore të detyrueshme), pra mbi 1.9 miliardë euro, ne e tenderojmë. Gjykata Europiane e Audituesve, institucioni më i lartë i auditimit në Bashkimin Europian, ka marrë në analizë në një vërtetim të saj të publikuar në korrik 2018, procedurat e prokurimit në vendet kandidatë për zgjerim për në BE, për vitin 2017. Kjo gjykatë, ndër institucionet e auditimit më të zhvilluara në botë, së bashku me GAO-n amerikane, ka gjetur se Shqipëria i zhvillon 30 për qind të prokurimeve publike të saj pa garë! Pra, nëpërmjet procedurës së negociimit, bisedimit. Me qindra miliona euro çdo vit i japim duke shmangur me marifet garën, nëpërmjet procedurës tashmë të bërë të famshme të prokurimit të drejtpërdrejtë, ngaqë në ankad ka ngelur vetëm një veprimtar, kompani private që do paratë e shtetit... Një procedurë e tillë, për shtete të ngjashme me ne, si Maqedonia apo Mali i Zi, zë vetëm rreth 5 për qind të vlerës së të gjitha prokurimeve publike. Tek ne jo, jemi rast i veçantë! Duhet të kemi gjashtëfishin e tenderave duke shmangur garën, ankandin e mirëfilltë. Një shqetësim të tillë ka disa vjet rresht që po e shpreh edhe institucioni i auditimit të jashtëm në vend, Kontrolli i Lartë i Shtetit. KLSH ka vërejtur raste të shpeshta kur, pas daljes së ofertave anomalisht të ulëta, disa operatorë (veprimtarë, kompani private pjesëmarrëse në garë) kanë refuzuar të paraqesin me shkrim sqarimet për ofertën anomalisht të ulët, e për pasojë automatikisht janë shkualifikuar nga procedura e prokurimit. Po kështu, edhe pas hapjes dhe leximit të ofertave nga komisionet shtetërore të vlerësimit të ofertave, disa operatorë ekonomikë kanë tërhequr në mënyrë të njëanshme ofertat nga procedurat e prokurimit. Duke hapur rrugën për procedurën e famshme (apo fameqe) me prokurim të drejtpërdrejtë, me negociim. Bisedim e çfarë bisedimi!



Është hapësira gri më e favorshmeja për marrëveshje okulte, për blerje të titullarëve publikë të institucionit që tenderon. Për pagesat nën dorë 10, 20 apo dhe 30 për qind, sipas oreksit të "sulltanit" firmosës të dikasterit përkatës.

KLSH e ka ngritur zërin fort, por ende qeveria i ka të dyja veshët të shurdhër: "Grupi i dytë i shkeljeve dhe dëmeve më të mëdha konstatohet përsëri në fushën e prokurimeve publike", shprehet KLSH në analizën vjetore 2017, më 15 shkurt

2018. "Vërehet një përqendrim i prokurimeve në një numër të kufizuar operatorësh... Në numër të lartë janë procedurat që kanë diferencën të larta të ofertës fituese dhe fondit limit, pra mbi 20%, fakt që ngre pikëpyetje si për saktësinë e

llogaritjes së fondit limit, ashtu edhe për uljen e ofertave në nivele që vënë në rrezik realizimin e shërbimeve, investimeve apo sigurimin e mallrave në cilësinë e duhur". Ç'do të thotë kjo? Do të thotë që me qindra milionë euro në prokurimet e fondeve publike nuk shpenzohen mirë, në bazë të normave të një administrate publike të përgjegjshme, se nuk sigurohet vlera e duhur për paratë e harxhuar lumë të taksapaguesve shqiptarë. Këto ditë po zhvillohet kampionati kombëtar i peshimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve tanë, në kuadër të vetingut në drejtësi. Emocionet për përjashtimin e atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk justifikojnë pasurinë e tyre vetjake janë të shumta dhe të natyrshme tek ne. Është revanshi qytetar i të gjitha zullumeve që gjyqtarët dhe prokurorët e shitur dhe të korruptuar na kanë shkakuar. Por vjedhjet më të mëdha në paratë e të gjithë neve nuk i kanë bërë gjyqtarët dhe prokurorët. Ata kanë qenë asistentë të vjedhjeve dhe mbrojtës me mosgjykimin dhe mosdënimin e vjedhësve publikë. Mirëpo vjedhjet janë kryer pikërisht nga ata që firmosin tenderat në fund, titullarët e institucioneve që shpenzojnë miliona dhe dhjetëra miliona euro. Dhe janë kryer shumica pikërisht tek tenderat e zhvilluar me bisedim, me negociim të drejtpërdrejtë nga prania e vetëm një ofruesi! Kambana e tundur së fundmi edhe nga Gjykata Evropiane e Audituesve, e tundur me dhjetëra herë fort edhe nga institucioni suprem i auditimit në vend, duhet dëguar nga dikush. Sigurisht që qeveria do të vijojë t'i ketë veshët e shurdhuar për këto kambana. Ndoshta Parlamenti mund të bëzajë? Si zor, interesat janë shumë të larta për të ngritur Parlamenti ynë komision hetimi. Ngelet vetëm opinionin i shëndoshë publik i vendit. Ngelet shpresa që nuk vdes kurrë se do të kemi "veting" edhe në ato qindra procedura të dyshimta tenderash publikë, që kanë masakruar paratë e të gjithëve. Një ditë.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ





Opinion i Ditës

# Requiem për Luan Hajdaragën! Do doja të ishte ndryshe mik...

Nga Përparim Kabo

(vijon nga faqja 1)

... mbyllnin çadrat dhe shkundnin palltot ose pardesytë... Ishim atje për një promovim libri. Ceremonia kishte nisur si ngahera me një lloj rituali, në fillim botuesi, pastaj autori (në këtë rast ishte autore) më tej foli një diplomat i lartë... dhe pastaj fjala iu dha udhëheqësit më të lartë të vendit. Në atë moment së bashku me njeriun e lirë Erjon Kristo ia behëm jashtë... fjalime të tilla nuk na kanë pëlqyer kurrë... dhe zëmë një tavolinë aty parl. Na u bashkua pas pak çastesh miku ynë i për-bashkët, Luan Hajdaraga... E ndihmuam të zinte vend, sepse ishte shumë i shëndoshë. E më tej nisi biseda. Fillimisht përse humbim nga vlerat promovimet ku kryesubjekt bëhen politikanët... ana komike e tyre që lexojnë atë që iu përgatisin të tjerët dhe më tej grotesku që lidhet me "mençuritë" e tyre që lind nga padija e xhelente... Qeshëm... Luani qeshte me gjithë shpirt, por ajo që më bënte përshtypje te ky njeri ishte mënyra si e vinte buzën në gaz... aq qetë dhe në mënyrë paqësore... Pas një pauze m'u drejtua: "Kur do na mbledhësh një herë të gjithë në petroninsat, do ishte një mrekulli", tha. "Mendoj vitin që vjen - i thash - është një përvjetor i plotë dhe mendoj të mblihdemi te Palati Kongresive... Do ishte një festë e vërtetë kur në skenë të ngjiteshin inxhinierët, matematikanët, fizikanët, mjekët, filozofët, studiuesit e shkencave shoqërore, ata të shkencave bujqësorë veterinarë, artistët, gjeologët dhe gjeodezët, ushtarakët... shkencëtarët e vërtetë që edhe jashtë kanë bërë sukses, mendimtarët e lirë dhe politikanët, shkrimtarët dhe poetët... Me të gjithë ata në breza bashkë do shikonim si u zhvillua vendi, si u bë Shqipëria...!" Eh - tha Luani dhe pasi mbylli pakëz kapakët e syve me një qesëndi tipike të tij nisi të fliste për gjimnazin "Petro Nini Luarasi" me detaje, për profesorët dhe profesoreshat, me adhurim, ashtu si dinte ai skaliti tipare të tyre, dashurinë dhe përkushtim, kontributet dhe mënyrën e komunikimit... Kujtesa ishte arma e tij e fortë dhe e patjetërsueshme. Erjoni kishte lëshuar një qeshje të ëmbël mbi fytyrë dhe e shihte drejt në sy sikur donte të përpinte fjalët pa dalë mirë, si thuhet... që në ajër... Miku ynë ishte në ujërat e tij, lundronte me një dashuri të paanë, pastaj kujtoi maturën e tij. Sullëm në mëndje Aleksandër Sallabandën, Shasenska Degën, Ilir Ficon dhe tim vëlla, që kishte qenë në një klasë me të, por ajo që më bëri përshtypje ishte fakti që Luani i kujtoi të gjithë djemtë e vajzat e klasës dhe me një adhurim



gati fëmijënor i përkëdheli mes kujtimeve. Në atë moment kaloi aty gruaja e një qeveritari të lartë, i foli dhe i dha dorën, mua dhe Erjonit jo, nuk na pa, ne nuk dukeshim... Luani e përcolli me një lloj buzëqeshjeje të sforcuar dhe vijoi:

"Mos u mërzite - i tha Erjonit? - Jo - tha Erjoni - po kënaqem, unë s'i kam ditur këto gjëra". Pastaj biseda vijoi për çështjen e Koresë, temë që ai e kishte debatuar në një forum televiziv. Kishin kaluar disa orë dhe ai me gojëmbëlsinë që e tip-

izonte ligjëronte me pasion. Kur u ngritëm dhe u përqaftuam nuk e dija që ishte hera e fundit... I ke mik, por biseda jonë vazhdon... Le kujtime, le punë dhe arritje, le një model... le një dhimbje dhe një boshllëk. Po, po biseda me ty dhe për ty vazhdon...!

## HOROSKOPI

### DASHI

Nëse ju dhe bashkëshorti juaj nuk jeni ndër të shumtë të lumtur gjatë këtyre ditëve, sot do të keni argëtim të çmendur. Ekziston mundësia që të kaloni momente të bukura duke bërë blerje.

### DEMI

Kjo do të jetë një ditë mjaft intensive. Qëndroni të përqendruar tek ajo që është me të vërtetë e rëndësishme për ju dhe mos e lejoni veten të kapeni pas gjërave të vogla. Një lidhje dashurie mund të lindë sot.

### BINJAKET

Sot është e rëndësishme që të ndërmerrni vendimet tuaja dhe t'i mbroshi ato. Ju e dini se çfarë është me mira për veten tuaj dhe të gjithë do të përfitojnë kur veproni sipas bindjeve tuaja. Nuk është koha për të qenë të dëshpëruar.

### GAFORJA

Ju jeni një ëndërrimtar. Të gjithë ju duan për këtë, por sot aspektet planetare kërkojnë praktikë. Ka qeshnje personale për të zgjidhur dhe nuk ka asnjë të mirë që ta mbani kokën në re. Kjo është një kohë për t'u përqendruar tek dashuria.

### LUANI

Shumë gjëra kanë ndodhur kohët e fundit në jetën tuaj. A i keni dhënë kohë vetes për të menduar mbi gjithë këto zhvillime? Është e mundshme që të ketë ndryshime të mëdha në punë. Qëndroni të përqendruar, në vend që të shqetësoheni për ngjarjet mbi të cilat nuk keni kontroll.

### VIRGJERESHA

Keni bërë progres gjatë këtyre javëve të fundit, veçanërisht për ato fusha të cilat ju kanë shqetësuar. Është një person rreth jush, misioni i të cilit duket të jetë që t'ju bëjë të shpërtheni nga nervat. Mos bini në këtë kurth.

### PESHORJA

Familja dhe miqtë mund të duken të ngadalltë ndaj një kërkese që keni pasur ndaj tyre. Mos u shqetësoni, sepse çdo gjë kërkon kohën e vet. Energjia planetare ju favorizon në fushën e biznesit.

### AKREPI

Kjo nuk është koha më e gëzuar, sepse çështjet e rëndësishme ende nuk kanë marrë rrugën e zgjidhjes. Është veçanërisht e rëndësishme që ju të bëni një përpjekje tjetër, duke mos hequr dorë lehtë.

### SHIGJETARI

Mos u përpuni që t'i bëni gjërat me detyrim. Konfigurimet planetare të sotme do të detyrojnë që më në fund të filloni të transformoni ëndrrat tuaja në realitet. Keni planifikuar për një kohë të gjatë pa bërë progres shumë konkret. E gjithë kjo është gati të ndryshojë.

### BRICJAPI

Ju jeni tepër produktivë, me aftësi të fortë biznesi. Sidoqoftë, kohët e fundit mund të jeni ndër të pakënaqur me atë se ku ndodhëni në jetë. Ndërsa shikoni përreth, mund t'ju ketë lindur dëshira që të keni më shumë pasuri. Mos e ndiqni këtë linjë mendimi.

### UJORI

Keni një mendje të mprehtë analitike që ju ka shërbyer mirë në biznes. Mjerisht kjo karakteristikë nuk ju shërben gjithmonë në jetën tuaj personale. Merrni pak më shumë kohë për të reflektuar mbi ngjarjet e javëve të fundit.

### PESHQIT

Ky është fillimi i një periudhe emocionuese në jetën tuaj të dashurisë. Të dy jeni gati për diçka të madhe. Ndiqni instinktet tuaja, sepse ato do t'ju udhëheqin aty ku duhet të shkoni. Edhe financat duken në rrugën e duhur.

## VENDIMI

# MID'HAT FRASHËRI

## Kthehen në atdhe eshtrat e gjenit të kombit

Diplomat, shkrimtar dhe politikian, ndër vite ndanë emrit të tij shquante përcaktimi 'rilindës'. Nipi i Samiut dhe Naimit, i njohur edhe me pseudonimin Lumo Skëndo (Mali Kockoja e Ismail Malosmani).

### FAIK KONICA E SHPALLTE SI MË ERUDITIN MES ERUDITËVE TË RINJ.

Kryetar i kongresit të M anastirit dhe nënkryetar i komisionit të hartimit të alfabetit, në shpalljen e pavarësisë ka qenë i zgjedhur delegat i Elbasanit. Ipekut, (Gjakovës, Plavës, Gucisë) dhe Përmetit; papajtuashëm me Esad Toptanin, emri e kontributi i tij gjendet në ngjarje të mëdha historike të Shqipërisë së vogël, derisa në Luftën e Dytë Botërore, ai pozicionohet me partinë Balli Kombëtar, qëndrimet e diskutueshme të së cilës bënë që pas lufte, emrit të tij t'i vishej një re e zezë sidomos pas konsolidimit të pushtetit komunist.

Veçse, më 1926-ën pat hapur në Tiranë librarinë e tij personale dhe në testamentin e mëvonshëm ai ia linte shtetit shqiptar pasurinë e vet, të tundshme dhe të patundshme, me qëllim krijimin e një instituti albanologjik në Tiranë, i cili do të merrej me studime në fushën e historisë së Shqipërisë. Sot rreth 40 000 vëllime të kësaj biblioteke ruhen (dhe janë pjesë) e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Dëshmitë thonë se gjatë një udhëtimi për në Nju Jork, SHBA, ai vdes si pasojë e një ataku kardial me 3 nëntor 1949. Vdiq beqar në moshën 69-vjeçare i detyruar të jetojë si renegat larg vendit të tij. "Shpirti i këtij njeriu të ndritëm u shkëput ditën e hënë, dita 3, vjeshëta e dytë ora 9.25 minuta në Nju Jork, hoteli "Winthrop". Tek trupi i tij kanë bërë roje nderi Shefqet Isaraj, Muho Xhakja, Astrit Sako, Braho Husi, Sulo Male, Hysni Aliko, Hajredin Peshkëpia, Skënder Omari, Iliaz Guri, Luan Dosti",



Mit'hat Frashëri

thonë dëshmitë që shtojnë se "Arkivoli me trupin e Mit'hat Frashërit u mbulua me flamurin kombëtar dhe u nderua nga gati 200 veta. Varrimi u bë në varrezat "Fernchff".

### VKM-JA VENDIM

PËR KTHIMIN NË ATDHE TË  
ESHTRAVE TË PERSONALITETIT TË SHQUAR TË LETRAVE SHQIPE DHE TË KULTURËS

### 32 milionë lekë të vjetra për procedurën nga Ministria e Jashtme

#### MBARËKOMBËTARE MID'HAT FRASHËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI

1. Kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar të letrave shqipe dhe të kulturës mbarëkombëtare Mid'hat Frashëri.

2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të organizojë procedurat e nevojshme ndër-shtetërore për të sjellë në atdhe eshtrat e personalitetit Mid'hat Frashëri.

3. Ceremonia shtetërore e kthimit në atdhe të eshtrave do të organizohet gjatë javës përkujtimore të 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit, 14-22 nëntor 2018, e cila përkon me një nga krem-

timet madhore të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

4. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", t'i shtohet fondi prej 3 239 400 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekësh, për organizimin e procedurave të nevojshme ndër-shtetërore për të sjellë në atdhe eshtrat e personalitetit të shquar të letrave shqipe dhe të kulturës mbarëkombëtare Mid'hat Frashëri, me qëllim zhvillimin e ceremonisë shtetërore gjatë periudhës 14-22 nëntor 2018.

5. Fondi prej 3 239 400 (tre milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekësh të përballohet nga fondet rezervë të buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

## "Rrok Academy", një shkollë për të fshehtat e improvizimit

Markelian Kapidani

Vijon viti i dytë i "Rrok Academy", kësaj "aventure", e cila brenda rrethanave të aktivitetit "Shkodra Jazz Festival" ndjek objektivin e formimit të muzikantëve të rinj duke vënë në dispozicion të tyre (si teorikisht po ashtu dhe praktikisht) gjuhën e muzikës xhaz. Vitin që shkoi, hapja e "Rrok Academy" u ndoq disa me ndrojtje nga studentët e muzikës, të cilët si doqoftë, shfaqën interes të dukshëm rreth muzikës së improvizuar.

Kush po ju shkruan, ka vite që jeton dhe punon sa në Itali dhe Zvicër dhe ka grumbulluar përjetatë karrierës një eksperiencë të mjaftueshme përmes lojës muzikore me artistë të ndryshëm me preardhje nga vende të ndryshme

### "Shkodra Jazz Festival" vjen në edicionin e dytë



të globit. Kjo përvojë është pikërisht pikënisja për të luajtur "muzikë sociale". Sociale apo shoqërore, mbasi muzika e improvizuar, pavarësisht se është një formë shprehjeje personale, ai bëhet një mjet komunikimi mes artistësh të ndryshëm, të cilët pavarësisht nga përkatësia etnike e ndryshme, bash-

këndajnë mes tyre gjuhën muzikore të xhazit si dhe dëshirën për tu argëtuar së bashku.

Kjo ishte dhe ideja e violinistit Rrok Jakaj në emrin e së cilit merr formë "Rrok Academy": një mjedis ku përveç mësimdhënies në lidhje me muzikën xhaz, studentët të mund të shkëmbejnë opinionet e tyre që kanë rreth muzikës duke rënë në kontakt me muzikantë të festivalit të cilët sjellin me vete përvojën e tyre muzikore për ta vënë atë në shërbim të studentëve.

Vjet ishte fillimi. Pavarësisht nga vështirësitë me karakter të ndryshëm që jo rrallë i dalin për gjatë rrugës risive duke u bërë shpesh edhe pengesë për ta, mendoj se "Rrok Academy", jo pa mund, arriti të hapë atë shteg të

nevojshëm që deri dje i mungonte panoramës së muzikës në vendin tonë. Konkretisht, "Rrok Academy" ka si qëllim t'u japë mundësi muzikantëve të rinj të njihen me botën e muzikës xhaz dhe me "të fshehtat e improvizimit", të fshehta në dukje por të njohura nga mjeshttrat e zanatit të muzikës xhaz.


Në "Rrok Academy Jazz" mund të ndjekin kursin që gjithë ata që kanë një përgatitje mesatare muzikore dhe që duan të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth muzikës xhaz. Për këtë gjë, studentët kanë mundësinë të kenë një tekst në gjuhën shqipe rreth teorisë së muzikës xhaz: ritëm, harmoni, formë, koncept improvizimi. Përveç leksioneve teorike, studentët kanë mundësinë të asistojnë në performanca ilustrative nga muzikantët pjesëmarrës në festival.

Ideja e "Rrok Academy" është

ajo që me kalimin e kohës, studentët që frekuentojnë rregullisht leksionet, të përfshihen gradualisht në performime brenda kontekstit të festivalit "Shkodra Jazz". Kjo gjë nuk është automatike. Sidoqoftë, ky i fundit është synimi, të cilin "Rrok Academy" ka vendosur ta realizojë brenda pak vitesh. Ne, së bashku me frekuentuesit e leksioneve, mund të bëjmë shumë për rritjen cilësore të muzikës në vend. Kjo është shtesa kryesore i "Rrok Academy". Muzika është një aktivitet që kërkon impetrim, përndryshe ajo ngelet në lëmin e diletantizmit. Nuk ka rëndësi se për çfarë stili muzikor bëhet fjalë. Rëndësi ka që muzika të bëhet me kriter profesional. Kështu, profesionalizmi bëhet "flamuri i Rrok Academy". Këtë vit, studentët që kanë ndjekur edicionin e vjetshëm kanë mundësinë të thellohen më tej përmes leksioneve të reja, ndërsa studentët e rinj që do marrin pjesë në leksione do kenë mundësinë të njihen me elementet kryesore të muzikës xhaz. Një verë e nxehtë plot muzikë ju pret në Shkodër nga fundi i gushtit.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Arbana aktor.
7. Kështu janë enigmat.
13. Bëjnë shumë të tilla fëmijët zevzekë.
15. Ishte familja e Henrikut VII.
16. Fund filmi.
17. Opera me Liu dhe Calaf.
19. Fillojnë një motiv
20. Eshhtë gjahu si çiftja.
21. Bëhen në stacione.
23. Fillojnë romanin
24. Eshhtë policia e FBI.
26. Të parat në stacion.
27. Mund të jepet me medalje.
28. Inicialet e Keaton aktore.
29. Dënoheshin nga Inkuizicioni të tillë.
31. Zanore për papare.
32. Fitohen nga ciklistët.
33. Me beach në një qytetë të Florida-s.
35. Shigjeta e argjenditë e Formula 1.

37. Eshhtë shërbimi me letra
39. Inicialet e Asimov.
40. Një rreth pa ekstreme.
41. Eshhtë syzë në komodinë.
42. Ndezur përgjysmë
44. Janë diletantë.
45. Memoria në computer.
46. Janë engjëj të Korit të lartë.

**VERTIKAL**

2. Ishin ushtarët e Pirros
3. Ekstreme në sektor.
4. Një katastrofë.
5. Kapur pa kufij.
6. Një pjesë e territorit.
7. Janë divane të sajuara.
8. Janë ndenjese në park.
9. Eshhtë mbikëqyrje ndaj të miturit.
10. Harris aktor.
11. Qyteti i përjetshëm.
12. Janë filmat me drita të kuqe.
14. Tigri i Malajzisë i Emilio Salgarit.
16. Ai i Madh u udhëhoq nga Mao Ce Dun.
18. Eshhtë vegël e... rrethimit.
22. Fillojnë sefte.
24. Janë besimet e besimtarëve.
25. Janë skuadra.
27. Janë linjat me tragete.
28. I preu Seneka.
30. Një pjesë e relacioneve.
31. Janë vendet ku prehen heronjtë.
33. Eshhtë detar si ai i Durrësit.
34. ... Villa në futbollin anglez
36. Loriku kuqezi.
37. Edith e La vie en rose.
38. Një mund të jetë fetar.
41. Janë tek në samba.
43. Bëjnë durim me uri.
44. Në krye të armatës.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Një Al famëkeq.
7. Eshhtë mjet lundrimi klandestinësh.
11. Ishte kryeperëndi nordike
12. Një pjesë e porosive.
14. Inicialet e Redford.
15. Mund të jetë emërore.
16. Eshhtë vegetacion.
18. Shkruhet shkurt mm.
19. Inicialet e Turgeniev.
21. Eshhtë e mërztishme.
23. Kështu thomë se është femra
25. Janë pjesë drame.
27. Kanë aderuar në parti.
28. Fillojnë teorinë.
29. Nikola Tesla.
30. Nuk kanë nevojë të rruhen.
31. Derek aktore.
32. Një pije aromatike
33. Pierre Daninos.

**VERTIKAL**


35. Eshhtë legjenda
36. Kështu thirrej Marco Pantani.
38. Lindsay aktore.
40. Kaplon të inatosurin.
42. Janë edhe ato të cirkut
44. Eshhtë numri i oktetit
45. Fillojë armataimin.
46. Janë pasuri të investuara.
47. Eshhtë shoshë.
8. Eshhtë pika delikate
9. Mali ku ngeci Arka.
10. Zanicchi këngëtare.
12. Janë shoferë të Formula 1.
13. Grone aktor.
16. Janë trarë.
17. Ulen në dhomën e lartë.
18. Janë sandale lëkurëkuqsh.
20. Dhjetë angleze.
21. Gënjëjnë për t'u bërë të famshëm.
22. Emri i Bismarck.
24. Gjysma e leqeve.
26. Janë katalizatorë të organizmit.
31. Duhën vadituri.
32. Kutia kur nuk... ka
33. Kush është... është në moshën e tretë.
34. D'Istria, alias Elena Gjika.
36. Sampras tenist.
37. Marsi i akcjeve.
39. Një pjesë e hepatiti.
41. Firar pa kufij
43. Fillojnë tatëpjetën.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

D A V I D R O C K L K R  
 E M E R K E N E A S E A N  
 M A L O T K E N E T A T A  
 I N N I M R O M A N E T  
 R R P A S I V E T T  
 M O K A S I N A I D E M  
 E M I R A T I A V A I I  
 S T A N E A T O M I K N  
 A R S T R E T E L O N D  
 R A S E M I K O R E  
 A T A T A K A T I D A R  
 H S T A R S I R T A R I

**FJALËKRYQI (2)**

B A L E N A A M M O T I  
 E N K A G A I U M A  
 K I M I K R K A R A T A  
 T I T P A L E T L I R I A  
 M A I P E T A L E T M R  
 T K M A K E T E T K O T  
 K A L K U L I M E T R E  
 M U L L E R M E T A L E  
 N A N B E T A T R E P O T  
 N A I F P I E T I D E  
 E T J E M I N A T O R E T  
 T I T R E N I T A F A T I

**SUDOKU**

		8	2		1			
	1		9	5				
	8	1			2	4	7	
9	7		5		6			
		4	1			8		
								9
5								6
	6							
		7	3					

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	7	3	2	6	9	5	8	4
5	8	9	4	1	3	6	7	2
4	2	6	7	5	8	1	9	3
2	9	1	5	8	4	7	3	6
3	4	5	6	7	2	8	1	9
8	6	7	9	3	1	2	4	5
9	1	4	8	2	6	3	5	7
6	5	8	3	4	7	9	2	1
7	3	2	1	9	5	4	6	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Zgjeni ata që janë duke fjetur dhe jo ata që ëndërojnë .. !!
- Gjysma e punës është mbaruar kur ajo fillohet me dëshirë.
- Njeriu i lirë është ai i cili nuk ka frikë për të shkruar deri në kufirin e logjikës së tij.
- Bëjini sytë katër para martesë, dhe mbajini gjysmë mbyllur pas martesë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

12	3	9	6	1	10	18	2	4	11	5	1
4	2	6	9	12	3	3	2	6	2	4	
15	8	4	7	3	1	5	1	1	11	14	
8	4	2	6	1	5	1	6	1	6	9	
8	4	1	6	13	3	2	6	11	7	6	
5	15	18	18	13	3	12	6	2			
2	1	7	14	2	2	6	2	7	14	6	
10	6	7	6	6	5	1	3	8	6	1	
6	1	4	1	12	10	6	6	6	7		
7	11	6	5	5	7	6	2	1	5		
7	18	4	15	1	6	7	5	14	1	5	1
5	6	4	1	1	2	4	1	5	11	5	

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
F	E	K	O	N	O	M	I	A	D	
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B
N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	
I	B	A	N	A	K	A	E	T		
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

*Thënie të mençura*

- - Mos lejon që valët të të nxjerrin atje ku ato duan. Shih si lëvizin, dhe harto drejtimin tënd.
- - "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse nuk jam atje, shkoj në punë".
- - Gjithçka që kërkohet është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të lumtur.
- - Ka njerëz që shembin me karakterin e tyre, atë që ata ndërtojnë me mendjet e tyre.

